



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

1. Seancë dëgjimore me Ministrinë e Drejtësisë.
2. Seancë dëgjimore me Shoqatën për Autonominë Vendore dhe Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Bashkim Fino, Elena Xhina, Edmond Leka, Spartak Braho, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Nikolin Staka, Xhemal Qefalia, Artemisa malo, Adelina Rista dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Alban Zeneli, Ediola Braha, Adriatik Alimadhi, dhe Tom Doshi

Të ftuar :

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë

Gentian Deva – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë

Evis Fico – këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë

Mirjana Zisi – Drejtoreshë e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Drejtësisë

Vilma Çausholli – përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave

Fran Brahimi – drejtor në Drejtorinë e Financave Vendore në Ministrinë e Financave

Erion Veliaj – Kryetar i Shoqatës për Autonomi Vendore, kryetar i Bashkisë Tiranë

Valbona Sako – zëvendëskryetare e Shoqatës për Autonomi Vendore, kryetare
Bashkisë Durrës

Adelina Farrici – Drejtore Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore

Alketa Daja – koordinatorë e financave vendore e Shoqatës për Autonomi Vendore

Jonida Halili – Drejtore e Buxhetit në Bashkinë e Tiranës

Ina Xhepa – Drejtore ekzekutive e Qendrës Europiane

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Jemi në ditën e tretë të dëgjesave për projektbuxhetin e vitit 2020, në vazhden e dëgjesave që bëjmë me të gjitha institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së komisionit tonë.

Sot kemi dëgjesën me Ministrinë e Drejtësisë për të prezantuar projektbuxhetin e vitit 2020. Të ftuar kemi zonjën Etilda Gjonaj, ministre e Drejtësisë. Mirë se keni ardhur, zonja Gjonaj!

Prezent kemi edhe stafin e Ministrisë së Drejtësisë, zotin Gentian Deva, sekretar i Përgjithshëm, Evis Fico, këshilltar i ministres së Drejtësisë dhe zonjën Mirjana Zizi, drejtore e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar. Nga Ministria e Financave kemi prezent zonjën Vilma Çausholli, përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit dhe zotin Brahimi, drejtor i Drejtorisë së Financave Vendore.

Ministria e Drejtësisë sot vjen në këtë dëgjesë për buxhetin dhe do të bëjë një prezantim të nevojave buxhetore për vitin 2020 për disa nga institucionet që janë në varësinë e Ministrisë së Drejtësisë, duke filluar me Qendrën e Publikimeve Zyrtare, me Mjekësinë Ligjore, sistemin e burgjeve, shërbimin e përmbartimit gjyqësor, shërbimet për çështjet e birësimeve, shërbimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, shërbimin e kthimit dhe kompensimit të pronave, Shërbimin e Provës, ndihmën juridike dhe rehabilitimin e të përndjekurve. Pra, janë disa agjenci që mbulon Ministria e Drejtësisë.

Zonja Gjonaj, po jua kaloj fjalën për të bërë një prezantim të nevojave buxhetore që ka Ministria e Drejtësisë. Pra, sa nga këto nevoja buxhetore janë akomoduar nga Ministria e Financave dhe qeveria në buxhetin e vitit 2020? Cili është suporti që ju kërkoni nga Komisioni i Ligjeve për të akomoduar ato nevoja buxhetore që nuk janë përfshirë në projektbuxhetin e vitit 2020?

Fjala është për ju.

Etilda Gjonaj – Përshëndetje!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të këtij komisioni,

Fillimisht dua të theksoj se buxheti për çështjet e drejtësisë është i ndarë në dy komponentë. Komponenti i parë ka të bëjë me buxhetin e planifikuar për vitin 2020 për sa i

përket mbështetjes financiare për zbatimin e reformës në drejtësi, duke përfshirë këtu të gjitha institucionet e reja të sistemit të drejtësisë dhe ato që janë planifikuar të ngrihen në vitin 2020. Ndërsa i dyti ka të bëjë me aspektet buxhetore të vitit 2019 dhe ato që janë planifikuar për vitin 2020, për të dhënë një parashikim më të qartë të prioriteteve dhe objektivave që duam të përmbushim për vitin 2020.

Fillimisht më lejoni të theksoj se dy prioritetet kryesore, të cilat janë prioritetet madhore qeverisë, ku mbështeten kërkesat kryesore të programit të Ministrisë së Drejtësisë janë: zbatimi i reformës në drejtësi dhe lufta kundër korrupsionit.

Nëse ndalemi të çështja e parë, që ka të bëjë me mbështetjen maksimale buxhetore të buxhetit të shtetit dhe qeverisë shqiptare për të gjitha institucioneve të reja të drejtësisë, pavarësisht se në mënyrë të vazhdueshme është theksuar pamundësia reale, duke e parë në termat e buxhetit, përsëri mbështetja buxhetore për zbatimin e reformës në drejtësi në asnjë moment nuk ka mundur, jo vetëm në aspektin e mbulimit të shpenzimeve të infrastrukturës, por edhe në atë të mbulimit të shpenzimeve për burimet njerëzore.

Buxhetit të sistemit të drejtësisë i është planifikuar t'i alokohet një shumë prej 5,7 miliardë lekësh, që e krahasuar me vitin 2019 ka një rritje me 11% më shumë ose në vlerë absolute ka një shtesë prej 6 milionë lekësh.

Deri në fund të vitit 2020 është planifikuar dhe përcaktuar të ngrihen institucione të reja dhe ky buxhet shtesë u vjen në ndihmë këtyre institucioneve, të cilat janë brenda parametrave të kuadrit ligjor. Nëse rritjen buxhetore të vitit 2019 e krahasojmë me vitin 2018, për shkak të ngritjes së institucioneve të reja rritja ka qenë 25%. Pra mbështetja në vlera reale buxhetore ka qenë jashtëzakonisht e madhe për sa i përket sistemit të drejtësisë. Kjo rritje reflekton qartë prioritetin e qeverisë shqiptare për të ngritur dhe forcuar të gjitha organet e drejtësisë me qëllim pasjen e një sistemi drejtësie të fortë dhe të paanshëm.

Për sa u përket disa institucioneve që nuk janë ngritur ende, për SPAK është parashikuar një fond prej 371 milionë lekësh dhe për KLP-në është parashikuar fondi me 154 milionë lekë.

Në vitin 2019 janë akorduar 313 milionë lekë për KLP-në, KLGj-në dhe për Shkollën e Magjistraturës, si dhe 2,5 miliardë lekë për shpenzime e investime të tjera.

Komisioni i Ligjeve e ka kryer dëgjuesën me të gjitha institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë, por do të më lejoni që në pak minuta të bëj një prezantim në nivel të përgjithshëm, për sa u përket shifrave buxhetore që janë dhënë për këto institucione, për të kuptuar të gjithë mbështetjen maksimale që i është dhënë nga buxheti i shtetit dhe shpesh herë nga Kuvendi për këto institucione.

Pagat e punonjësve për institucionet e sistemit të drejtësisë për vitin 2019, në krahasim me vitin 2018, janë rritur me 29 % dhe për vitin 2020 është planifikuar një rritje me 28% për pagat.

Një arritje e rëndësishme është krijimi i infrastrukturës përmes investimeve të bëra në vitet 2018 dhe 2019, por edhe viti 2020 nuk do të ngelet pas me investimet në sistemin e drejtësisë. Një ndër prioritetet kryesore që është vendosur për vitin 2020 është përfundimi i sistemit elektronik unik, që ka të bëjë me administrimin e të dhënave gjyqësore, ku sistemi prokurorisë, sistemi gjyqësor dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë do të kenë akses së bashku, pra që të kemi një sistem unik ashtu siç e parashikon teknologjia dhe legjislacioni në fuqi.

Në vitin 2019 një ndër objektet infrastrukturore më të mëdha të investuara ka qenë Poli i Drejtësisë, për sa i përket akomodimit të tri institucioneve, si: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Shkolla e Magjistraturës. Për Polin e Drejtësisë janë alokuar rreth 551 milionë lekë investime, nga të cilat 313 milionë lekë janë investime në sistemet IT-së dhe pajisje TIK dhe 238 milionë lekë janë për pajisje zyre.

Çështja e dytë apo shtylla e dytë që lidhet me mbështetjen që buxheti i shtetit u jep çështjeve të drejtësisë, që ka të bëjë me aparatin e Ministrisë së Drejtësisë dhe institucionet e varësisë, me qëllim për të realizuar të gjitha prioritetet dhe objektivat që janë vënë si qëllim në krye të këtij mandati.

Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë në total për vitin 2020 është planifikuar në shifrën 11 miliardë e 37 milionë e 390 mijë lekë, ku zërat kryesorë janë jo vetëm programet, planifikimet, menaxhimet dhe administrimi, por edhe buxhetet për institucionet e varësisë, si: ndihma juridike, publikimet zyrtare, mjekësia ligjore, shërbimi përmbarimor gjyqësor, shërbimi i birësimeve, kthimi dhe kompensimi i pronave, Shërbimi i Provës dhe sistemi i burgjeve.

Po ta shikojmë në vlera reale, ky buxhet i krahasuar me vitin 2019 ka një ulje prej 9,5%, e shprehur në shifra absolute është një ulje me 1 miliard e 164 milionë e 368 mijë lekë. Arsytet e uljes së buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2020 janë dy. E para, për shkak se institucioni i ALUIZNI-it nuk është më në kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë, por të Kryeministrit dhe të gjitha fondet kanë kaluar në buxhetin e Kryeministrit.

Arsyeja e dytë ka të bëjë me kalimin e fondeve të investimeve për sistemet e infrastrukturës dhe teknologjisë pranë AKSHI-t. Kjo do të thotë që për të gjithë parametrat, për sa u përket zërave të buxhetit, nuk ka ulje, por ka rritje në sektorë që janë prioritarë, siç është rritja e sigurisë në sistemin e burgjeve, pasi ky është fokusi dhe prioriteti kryesor, duke e konceptuar si luftë kundër krimit të organizuar dhe kriminalitetit në përgjithësi.

Gjithashtu, do të ndalem te dy investimet që i përkasin buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe në 2-3 elemente të rëndësishme të institucioneve të varësisë, që përkojnë me prioritetet. Një investim prioritar i ministrisë ka të bëjë me ndërtimin dhe mobilimin e institucionit për edukimin dhe rehabilitimin e të miturve, i cili në vitin 2020, si vit i parë, është planifikuar të investohet në vlerën 118,2 milionë lekë. Institucioni për Edukimin dhe Rehabilitimin e të Miturve është një nga prioritetet që lidhet me zbatimin e drejtësisë penale për të miturit, si pjesë e reformës së madhe në drejtësi dhe për këtë arsye është konsideruar si një investim prioritar që gjen vend në buxhetin e vitit 2020. Pra duke e mbështetur në zëra financiarë dhe buxhetor që lidhen me pajisjet elektronike apo zyrash, të cilat do të bëjnë të mundur funksionimin e qendrës së dytë, që është Qendra për Parandalimin të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, e cila është një kërkesë e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

Për sa i përket drejtësisë për të miturit, për vitin 2020 për herë të parë ka një buxhet të konsiderueshëm në vlerën 229,3 milionë lekë. Me këtë investim Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si mekanizëm dhe institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, do të hartojë programe parandaluese dhe do të mbikëqyrë për një periudhë 6-mujore të miturit pas përfundimit të dënimit. Pra është një nga qendrat më të rëndësishme për të cilën kemi pasur mbështetje edhe nga partnerët ndërkombëtarë, si në aspektin teknik dhe atë buxhetor për trajnimin e stafeve, të cilët do të shërbejnë pranë kësaj qendre

Për sa i përket funksionimit të institucionit, është parashikuar fondi në vlerën 204,3 milionë lekë, nga të cilat 118,2 milionë lekë janë planifikuar për ndërtimin e këtij institucioni.

Gjatë vitit 2019 këto parashikime buxhetore duhet të ishin realizuar, por për shkak të prioritetëve, të cilat kanë qenë të shumta në numër, mbështetja buxhetore për zbatimin e drejtësisë penale për të miturit është planifikuar në vitin 2020.

Gjatë vitit 2019 Ministria e Drejtësisë së bashku me aktorët e tjerë është ndalur në hartimin e të gjitha akteve nënligjore dhe plotësimin e bazës ligjore me qëllim që të gjitha këto institucione apo qendra të reja të mirëfunksionojnë në momentin që do të jenë efektive në trajtimin e të miturve dhe në kontakt me organet e drejtësisë.

Për sa i përket sistemit elektronik të të dhënave të drejtësisë penale për të miturit, gjatë vitit 2019 është punuar për krijimin dhe vënien në funksion të tij. Kjo pa dyshim që është një tjetër sfidë e rëndësishme, por në të gjitha rastet, në vitin 2019, por edhe për vitin 2020, bashkë me stafin financiar dhe administrativ të Ministrisë së Drejtësisë do të mundohemi të ndajmë politikat apo prioritetet që mund të mbështeten nga donatorë të ndryshëm me ato që mund të rëndojnë në buxhetin e shtetit. Pra, sistemi elektronik është një sistem që mundësohet

financiarisht nga UNICEF-i, i cili ka dhuruar sistemin e punuar në bashkëpunim me AKSHI-n.

Për sa i përket forcimit të luftës kundër korrupsionit në administratë, padyshim që një sërë ndryshimesh janë kryer edhe gjatë vitit 2019. Funksionimi i task forcës ka sjellë rezultate shumë të mira, pa pasur një kërkesë buxhetore shtesë.

Në vitin 2019 ka pasur edhe një ndryshim në strukturën e Ministrisë së Drejtësisë, duke i dedikuar një drejtori specifike për çështjet e antikorrupsionit, jo vetëm në aspektet parandaluese, por edhe në ato ndëshkuese dhe njëkohësisht ndërgjegjësuere për qytetarët.

Duke mos dashur të rëndojmë buxhetin, sepse janë disa zëra të tjerë buxhetorë që janë më të nevojshëm të gjejnë vend në buxhet, Ministria e Drejtësisë ka pasur bashkëpunim dhe mbështetje të jashtëzakonshëm nga Komisioni European, pra ka pasur edhe mbështetje buxhetore të kontratës sektoriale, për luftën kundër korrupsionit, në shumën prej 10 milionë eurosh, ku gjatë vitit 2019 janë disbursuar 2,3 milionë euro në buxhetin e shtetit.

Për sa i përket vazhdimësisë Komisioni European për vitin 2020, duke pasur edhe ndjeshmërinë e zërave financiarë, do të asistojë Ministrinë e Drejtësisë në këtë luftë me asistencë teknike në vlerën 1,5 milionë euro.

Për sa i përket ndihmës juridike, e cila gjen një vend të posaçëm në zërat buxhetorë dhe pa dyshim është një ndër treguesit kryesorë të zbatimit të reformës në drejtësi, por është edhe pjesë mbështetjes buxhetore që Komisioni European jep për zbatimin të reformës në drejtësi në kontratën sektoriale në shumën prej 42 milionë eurosh. Kjo kontratë sektoriale dhe kjo mbështetje buxhetore është me kusht, pra në momentin që realizohen indikatorët e përcaktuar nga Komisioni European, lidhur me zbatimin e objektivave. Pra ndihmave juridike është një nga 7 indikatorët e kërkuar nga Komisioni European me qëllim që ne të kemi mundësi të disbursojmë dhe të fitojmë të drejtën për të pasur në buxhetin e shtetit mbështetjen buxhetore që i jepet në vlerën totale prej 42 milionë eurosh, ku pjesën kryesore të kësaj mbështetje e zë ndihma për të gjithë institucionet e reja të drejtësisë dhe zbatimin e reformës në drejtësi.

Për sa u përket zërave financiarë në buxhetin e shtetit për ndihmën juridike, dua të them që për vitin 2020 është parashikuar 78 milionë lekë, duke përfshirë shpenzimet korrente dhe kapitale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

78 milionë lekë.

Ndërsa për sa i përket mbështetjes nga partnerët, për t'ia kursyer buxhetit të shtetit, siç e thashë duke orientuar të gjitha politikat që në fillim të vitit secilën pjesë të zërave dhe prioritetëve do ta mbulojnë partnerët. Në rastin konkret ka qenë një mbështetje e UNDP-së së

bashku me agjencinë e bashkëpunimit austriak, të cilët nënshkruan një kontratë me vlerë 1 milion dollarë, që do të japin mbështetjen për qendrat e reja në rrethe të ndryshme. Një mbështetës kryesor ka qenë edhe fondacioni SOROS.

Për sa i përket Qendrës së Botimeve Zyrtare, Institutit të Mjekësisë Ligjore, Komitetit të Birësimeve, Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor apo institucioneve të tjera, të cilat janë institucione të varësisë, nuk ka ndonjë ndryshim apo risi për t'u theksuar. Nëse do të ketë interes në pyetjet tuaja, këtu kemi drejtoreshën e Buxhetit së bashku me sekretarin e Përgjithshëm.

Unë do të ndalem në dy elemente kryesorë, që ia vlen për t'i theksuar, pra është buxheti i akorduar për Agjencinë e Trajtimit të Pronave dhe ka të bëjë me kompensimin e 1000 subjekteve. Për vitin 2020 është parashikuar që buxheti i shtetit do të mbështesë Agjencinë e Trajtimit të Pronave me një fond prej 3 miliardë e 768 milionë lekë nga të cilat 3,5 miliardë lekë janë për kompensimin e 1 mijë subjekteve lidhur me vendimmarrjen, që është mbyllur me sukses në shkurt të vitit 2019.

Po ndalem te sistemi i burgjeve. Për vitin 2020, brenda tavaneve buxhetore për sistemin e burgjeve, janë planifikuar rreth 5,9 miliardë lekë në total, ku, pa dyshim, në krahasim me vitin 2019 kjo vlerë ka një rritje, pasi buxheti për vitin 2019 ka qenë 5,5 miliardë lekë.

Kryesorja, për të cilat ne kemi komentuar edhe zërat buxhetorë, ku do të financohet për vitin 2020 në sistemin e burgjeve, ka të bëjë pikërisht me vazhdimësinë e atyre projekteve, të cilat janë të rëndësishëm për rritjen e elementeve të sigurisë. Një ndër elementet më të rëndësishëm është pikërisht zbatimi i sistemit të regjimit "41 Bis", i cili edhe gjatë vitit 2019 ka kërkuar investime dhe shpenzime të zërave buxhetorë për sa i përket përshtatjes me qëllimin që në dy burgjet kryesore të ndërtohen seksione përkatëse me infrastrukturën e nevojshme sipas modelit italian.

Për sa u përket investimeve të tjera në sistemin e burgjeve, mendohet të vazhdojnë edhe në vitin 2020, të cilat kanë të bëjnë edhe me pjesën e infrastrukturës për teknologjinë, ku një pjesë prej tyre do të gjejnë vend në buxhetin e shtetit dhe pjesa tjetër po shikohet mundësia për t'u mbuluar me fonde nga projektet e Komisionit European apo edhe nga ndihma buxhetore që vetë SHBA-të i kanë dhënë sistemit të burgjeve, duke e futur si ndër prioritet e tyre kryesore.

Një element i dytë që dua të ndalem për sa i përket pjesës së buxhetit të sistemit të burgjeve ka të bëjë me pagat dhe shpenzimet për burimet njerëzore. Në datën 1 prill të vitin 2019 u vendos rritja e pagave me 7% për punonjësit e Policisë së Burgjeve Ishte hera e parë që u bë një rritje kaq e madhe për punonjësit e Policisë së Burgjeve në vlerën totale prej 181 milionë lekë, por, nga ana tjetër, ky objektivi ka vijuar, duke u parashikuar edhe në hartimin e projektligjit për Policinë e Burgjeve, i cili tashmë ka ardhur për diskutim në Kuvend, ku,

gjithashtu, parashikon një rritje në vite, duke përfshirë 3 vjet, duke filluar nga viti 2020 deri në vitin 2022. Kjo bëhet, me qëllim që edhe pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve të barazohen me punonjësit e Policisë së Shtetit. Për kategoritë specifike, sidomos për ata, të cilët do të zbatojnë dhe do të monitorojnë zbatimin e regjimit të posaçëm “41 Bis”, po shikohet mundësia që brenda zërave dhe tavaneve buxhetore të jepet një rritje për shkak të vështirësisë që ka kjo trupë speciale. Kjo rritje është parashikuar edhe në projektligj, ku këta punonjës do të trajtohen më mirë financiarisht se pjesa tjetër e punonjësve të Policisë së Burgjeve.

Elementi i fundit ka të bëjë me çështjen e trajtimit financiar të diferencuar për punonjësit mjekësorë apo për stafin mjekësor në sistemin e burgjeve, i cili, për shkak edhe të trajtimit jo të mirë financiar, ka sjellë një sërë vështirësish, një sërë pengesash për të rekrutuar mjekë, infermierë apo kujdestarë, të cilët janë shumë të nevojshëm edhe për faktin që sistemi i burgjeve tashmë ka në fokusin e tij trajtimin dhe rehabilitimin e të dënuarve.

Unë doja të bëja një prezantim të shkurtër, ndaj u ndala te çështjet kryesore. Pa dyshim, së bashku me stafin, jemi të hapur për të gjitha pyetjet që mund të keni lidhur me termat financiarë.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Ministre!

Në fakt, para se t'ia kaloj fjalën zotit Fino, dua t'ju falënderoj për prezantimin e buxhetit të reformës në drejtësi, edhe pse në këto dy ditë të dëgjësive tona për projektbuxhetin i kemi pasur me radhë të gjitha institucionet e drejtësisë në Komisionin e Ligjeve, por ky prezantim i detajuar tregon edhe një herë seriozitetin dhe mbështetjen që qeveria ka për zbatimin e plotë të reformës në drejtësi. Me të drejtë kolegu Fino ditën e parë të prezantimit të projektbuxhetit të vitit 2020 nga Ministria e Financave tha se, nëse do t'i vendosim një emër këtij projektbuxheti, do ta quanim projektbuxheti i drejtësisë. Ky buxhet në terma të përgjithshme vjen me 6,6% rritje në raport me vitin 2019 ose në vlerë është rreth 1,1 miliardë më shumë se sa në vitin 2019, pa llogaritur këtu fondin rezervë për zbatimin e reformës në drejtësi 300 milionë, që është në dispozicion, si dhe fondin e krijuar që në buxhetin e vitit 2019, që do të vazhdojë të jetë pjesë e fondit rezervë të qeverisë për buxhetimin e plotë të zbatimit të reformës në drejtësi.

Po ashtu, gjej me vend të theksoj se ky buxhet i jep fond Ministrisë së Drejtësisë edhe për luftën kundër korrupsionit. Gjithsesi, për një prezantim të gjetjeve të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2020 unë do t'ia kaloj fjalën relatorit, zotit Fino.

Bashkim Fino - Faleminderit, kryetar!

E falënderoj ministren e Drejtësisë dhe stafin e saj që janë sot këtu!

Tani unë e kam më të thjeshtë pas fjalës së ministres dhe fjalës suaj parathënëse, që ju e bëtë si konkluziv. E mira do të ishte që ta thoshit në fund këtë që thatë. Por ajo që na e bën neve më të thjeshtë, pasi kemi disa ditë që diskutojmë, është, siç tha edhe ministrja, që ne si komision e kemi marrë me seriozitet këtë diskutim të projektbuxhetit. Gjatë këtyre ditëve të gjitha institucionet që kanë qenë dhe ato që janë krijuar me ligj, si: Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata Kushtetuese, Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisioneri Publik, kanë qenë prezent në komisionin tonë dhe kanë diskutuar për projektbuxhetin. Pavarësisht se kjo nuk është pjesë e Ministrisë së Drejtësisë, por që ministrja këtu e trajtoi me të drejtë, kështu edhe ne me të drejtë e kemi cilësuar këtë buxhet si buxheti i zbatimit të reformës në drejtësi, aq të mirëpritur nga opinioni i brendshëm dhe nga miqtë tanë ndërkombëtarë. Nga kjo pikëpamje, nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Qeveria nuk ka krijuar asnjë lloj problemi gjatë këtyre dy vjetëve për të gjitha këto institucione që ne ua kemi ngritur me koshiençë fondet financiare. Të paktën kur vjen buxheti i shtetit nuk duhet të mungojnë për asnjë moment, në mënyrë që funksionaliteti i këtyre institucioneve të jetë në lartësinë e duhur nga pikëpamja financiare, kurse nga pikëpamja profesionale nuk jemi ne që duhet të gjykojmë kur ata vijnë dhe raportojnë këtu apo kur kemi një komision të ngritur të posaçëm për realizimin e tyre. Shifrat gjithmonë mund të jenë të pakënaqshme për çdo ministër. Unë kam qenë vetë drejtues dhe, natyrisht, që çdo buxhet në çdo ministri kërkon më shumë dhe është normale që të kërkojë më shumë. Pavarësisht ekspozesë suaj shumë të mirë që bëtë këtu me shifrat që paraqitët, ju, në diskutim me Ministrinë e Financave, keni arritur në përfundimin se ministria dhe të gjithë sektorët që mbulon ministria juaj, siç i përmendët me radhë, do t'i realizojnë detyrat e saj për vitin 2020. Ajo që unë do të doja vërtet t'ju pyesja është: gjatë këtyre ditëve më kanë lënë një perceptim të gabuar (mbase jo vetëm mua, por edhe kolegëve të mi deputetë) të gjitha institucionet që kanë ardhur këtu dhe që janë interesuar për buxhetin e tyre për vitin 2020 në sensin e fondeve që janë, por ata kërkojnë më shumë shpërblime për stafin ndihmës, kërkojnë sekretarë, kërkojnë shoferë, madje kërkojnë edhe shpërblime për këshilltarët e tyre. Unë pardje u dhashë një shembull, duke iu thënë se nëse do të ishte puna për të dhënë shpërblime, ne mund t'ua japim këshilltarëve tanë të Kuvendit, sepse këshilltari i Kuvendit, në vlerësimin tim, edhe për shkak të vjetërsisë që kam në parlament prej 22 vjetësh, është shumë herë më i lartë, pasi përgatit projektligjet, i diskuton dhe i miraton. Këto janë punë detyruese për të gjitha institucionet që ju keni në varësi. Pyetja ime e parë, dhe vërtet dua një përgjigje të sinqertë është: a keni ju një strukturë të posaçme organizative brenda Ministrisë së Drejtësisë për të monitoruar ecurinë e procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve të reja të

reformës në drejtësi? Pse e bëj këtë pyetje? Unë do të vazhdoj të bëj edhe dy pyetje të tjera për t'u kthyer te pyetja e parë, në mënyrë që të kaloj te thelbi i pyetjes së parë. A keni ju një informacion (ne e kemi dhe e kemi diskutuar këtu kur ishte Prokuroria e Përgjithshme) se sa burime njerëzore dhe financiare kërkojnë dy institucionet që ju thatë? Me shifra, në mos gabo, ishin 371 milionë lekë dhe 154 milionë lekë për ngritjen e SPAK-ut, BKH-së dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. A ekziston kuadri i nevojshëm ligjor kur këto institucione të fillojnë funksionimin e tyre në fillim të vitit 2020, të cilat duhej të kishin filluar në vitin 2019, por nuk ndodhi? Për hir të së vërtetës, kjo është detyra juaj dhe e Ministrisë së Financave: për të vënë në zbatim funksionimin e tyre. Për shembull, në ligjin nr. 96/2016, që kemi miratuar, në nenin 12 një nga elementet e pagës së magjistratit është shtesa për vështirësi në punë të magjistratit që punon në SPAK. Sipas përcaktimit të shkronjës "d", thuhet: "Shtesë për vështirësi në punë, sipas parashikimeve të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". A është miratuar një akt nënligjor që përcakton këtë shtesë mbi pagën, sikurse është miratuar aktualisht një VKM për komisionerët e institucioneve të rivlerësimit? E njëjta pyetje është edhe për përcaktimin e pagave të punonjësve të administratës së këtyre institucioneve, nëse ka apo jo një akt ligjor apo nënligjor. Në vazhdim të kësaj, zonja Ministre, më duhet t'ju them se së bashku me kryetarin e komisionit kemi bërë një debat shumë profesional në sensin financiar, jo në sensin e punës, me drejtuesit e reformës së vetëqeverimit.

Në nenin 29 "Paga dhe përfitimet e anëtarëve dhe këshilltarëve", pika 5, të ligjit nr. 84/2016 thuhet: "Këshilltari ligjor dhe ekonomik përfiton përkatësisht 80 për qind të pagës mujore përkatëse të anëtarit të institucionit të rivlerësimit (gjë të cilën ata tashmë e marrin. Pra, në qoftë se unë jam këshilltar apo nëpunës në një nga këto institucionet e vetëqeverimit, do të marr 80% të pagës së gjyqtarëve që janë atje) Ata përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë, sipas rastit". Me këtë të drejtë që atyre u jep ligji unë dua që ju, personalisht, së bashku me Ministrinë e Financave, të jepni absolutisht ndihmesën tuaj duke realizuar një akt nënligjor. Ju duhet të nxirrini sa më shpejt një VKM për të vlerësuar pikën 5 të nenit 2, pra për të vlerësuar dhe për të përcaktuar se sa do të jetë vështirësia dhe vjetërsia e këtyre punonjësve për të marrë shtesë. Besoj se këtë duhet ta dijë edhe publiku. Pra, ata marrin 80% të pagës, por për shkak të ligjit ata duhet të marrin edhe për vjetërsi, edhe për vështirësi, të cilat duhet të dalin me vendim qeverie, në mënyrë që të mos lejojmë, zonja Ministre, siç bëri KPA-ja, që mbledhi Kolegjin Gjyqësor (i cili nuk është krijuar për atë punë dhe nuk e ka detyrë funksionale që të mbledhë gjyqtarët, por ka detyrë funksionale që të bëjë vetëqeverimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve) se nuk kishte paga për 2 muajt e fundit për punonjësit. Pra, ky ishte thelbi

kryesor, mblodhi gjyqtarët për t'u thënë: “Unë po ju jap 3 rroga shpërblime vartësve të mi”, gjë që është në kundërshtim me ligjin financiar dhe në kundërshtim me buxhetin e shtetit. Unë jam shumë i bindur dhe i bëj thirrje kryetarit të KLSH-së që t'i kontrollojë këto institucione nga pikëpamja financiare, sepse bëhet fjalë për lekët e taksapaguesve shqiptarë dhe nuk mund të abuzohet me to dhe të arrijmë në konkluzionin që tha kryetarja e KPA-së këtu se kishte 2 muaj pa paga. Ajo kishte mbetur pa paga, sepse kishte marrë nga fondi i pagave të vitit 2019, gjë që edhe një financier me shkollë të mesme ekonomike nuk mund ta bënte, sepse nuk ka të drejtë të prekë fondin e pagave për vitin 2019 dhe nga ky fond të japë shpërblime. Nga fondi i pagave nuk mund të japësh kurrë shpërblime, sepse në momentin kur jep shpërblime është normale që do të mbetesh pa paga 2 muajt e fundit.

Zonja Ministre, po kthehem te pyetja e parë, sepse është një pyetje që ka rëndësi të jashtëzakonshme. A keni ju një strukturë organizative për të monitoruar ecurinë, për t'i ndihmuar këta nga pikëpamja organizative, jo nga pikëpamja në themel të ligjit pse ato janë krijuar, sepse ne absolutisht nuk kemi të drejtë as politikisht të ndërhyjmë te vendimmarrja e tyre, por nga pikëpamja organizative dhe nga pikëpamja financiare? Nga pikëpamja e buxhetit ne kemi të drejtën ligjore, se janë paratë e taksapaguesve shqiptarë, sepse kjo është thembra e Akilit në të cilën ne duhet t'ua kërkojmë me forcë atyre që të jenë tepër korrektë, pasi u kemi dhënë fonde të jashtëzakonshme. Pra, fondet që ka sistemi i drejtësisë (zonja Ministre, kjo është edhe merita juaj, por edhe merita politike e kësaj qeverie) janë të jashtëzakonshme. Unë e kam thënë vitin e kaluar, por po e them edhe sot se kjo është një fashë e përbërë nga 790 veta, nga të cilët 472 janë gjyqtarë dhe 318 janë prokurorë, të cilët marrin një pagë dy herë më të lartë se Presidenti i Republikës. Ne e kemi miratuar pagën e Presidenti i Republikës në nenin 12, i cili e ka 257 mijë lekë. Pse e kemi miratuar ne pagën e Presidenti të Republikës? Ne e kemi miratuar për të treguar piramidën e pagave në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që kjo fashë prej 790 veta kanë dalë mbi këtë. Ne e kemi bërë këtë gjë me koshiençë dhe shumë mirë që e kemi bërë. Mbase me "hile" kanë përfituar edhe disa institucione të tjera, që e kanë barazuar pagën e tyre me pagën e kryetarit të Gjykatës së Lartë, kryetarit të KLSH-së, Avokatit të Popullit e të tjerë me radhë, sepse edhe ata marrin një pagë më të lartë. Ne këtë e kemi bërë me koshiençë dhe u kemi dhënë të gjithë mundësinë financiare për ta trajtuar dhe për të qenë sa më të qetë në punën e tyre për të bërë vetëpunë, pa iu futur më pas analizës se sa është ecuria e vetëpunës, sa e kanë realizuar e të tjera, sepse sot nuk jemi mbledhur për të folur për këto, por për çështje financiare.

Unë mendoj se ju duhet të keni një strukturë organizative dhe do t'ia propozoja edhe Ministrisë së Financave, qoftë edhe me 3 apo 4 veta, duke shtuar edhe numrin e punonjësve

Ministrisë së Drejtësisë, si dhe një fond page për të monitoruar pikërisht këtë gjë, sepse edhe Ministria e Financave do të përfitojë dhe do të kursejë më shumë nga kjo gjë. Në momentin që ne vërtet kemi një nukël monitorimi pranë ministrisë për ecurinë e procesit dhe ngritjes së këtyre institucioneve që këto të mos kenë asnjë lloj mundësie të ankohen kur të vijnë këtu, gjithmonë flas nga pikëpamja financiare. Pra, duke pasur këtë nukël, ne do të bëjmë të mundur të zgjidhim shumë problematika, që kanë të bëjnë me akte nënligjore apo me udhëzime të veçanta e kështu me radhë. Unë i bëra këto 3-4 pyetje teknike, sepse nga pikëpamja e shifrave Ministria e Drejtësisë është shumë mirë. Ne bëjmë shumë mirë që Ministrinë e Drejtësisë e lëmë në fund, pasi i kemi dëgjuar të gjitha institucionet kushtetuese dhe ato që kemi krijuar me ligj, sepse bëhet një ombrellë përmbyllëse e të gjithë situatës për të ditur dhe për të marrë një *feedback* edhe në të ardhmen, kur të vijnë të raportojnë për veprimtarinë e tyre si institucione.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj - E dëgjova me shumë vëmendje zotin Fino në gjithë diskutimin e tij dhe, pa dyshim, edhe çështjet e ngritura si shqetësime. Për hir të së vërtetës çështja e mungesës së buxhetit apo e kërkesave për rritje buxheti të komisioneve të vetingut, të cilëve për shkak të parashikimit ligjor, që është neni 29, pika 5, u njehet mundësia e trajtimit. Ky parashikim ligjor nuk është shumë i detajuar, sepse thuhet: "Këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë, por sipas rastit". Edhe unë dua ta ritheksoj edhe një herë, sepse duket sikur është bërë një padrejtësi shumë e madhe, se përtej të gjithë mbështetjes vërtet të jashtëzakonshme buxhetore që është dhënë dhe rritjes së pagave të të gjithë anëtarëve të komisioneve të vetingut, por edhe stafëve të tyre mbështetëse, një këshilltar e merr pagën 80%. Pra, këshilltarët ligjorë marrin 80% të pagës së anëtarëve të komisionit, të cilët, ashtu siç e përmendi zoti Fino, e kanë sa dyfishin e pagës së Presidentit të Republikës. Tashmë piramida e pagave ka ndryshuar dhe pjesa e sistemit të drejtësisë të institucioneve të vetingut, anëtarët e këshillave kanë tërësisht një ndryshim shumë të madh për sa i përket trajtimit me pagë. Unë jam absolutisht dakord me shqetësimin e zotit Fino që ne, së bashku me Ministrinë e Financave, duhet patjetër të bëjmë një proces diskutimi për të parë mundësinë e normimit nëpërmjet një akti nënligjor për të përcaktuar se si rregullohet procesi për marrjen e pagës shtesë dhe kur do të jenë këto rastet. Pra, për ta detajuar dhe për ta normuar, me qëllim që edhe institucionet e sistemit të drejtësisë të kenë një normim të ngjashëm për sa i përket trajtimit me pagë shtesë për shkak të vështirësisë, për shkak të orëve shtesë apo të të gjitha elementeve, të cilat ata i kanë ngritur në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet shkresave, njëkohësisht të kemi

mundësinë edhe të një miradministrimi dhe mirëpërdorimi të buxhetit nga ana e këtyre institucioneve të larta të drejtësisë.

Lidhur me pjesën nëse ka një nukël që monitoron institucionet e drejtësisë, në fakt, ka një strategji ndërsektorale të drejtësisë, ku kësaj strategjie i është bashkangjitur edhe plani i veprimit, i cili është për zbatim të kësaj strategjie dhe përfshin jo vetëm Ministrinë e Drejtësisë, por të gjitha institucionet e reja të drejtësisë dhe të gjithë aktorët që marrin pjesë në zbatimin e reformës në drejtësi. Ky planveprimi ka si koordinator kryesorë Ministrinë e Drejtësisë dhe, në kuadër të këtij planveprimi dhe të kësaj strategjie, vjen edhe mbështetja buxhetore, që unë përmenda, nga Komisioni Europian, i cili ka të bëjë pikërisht me faktin që ka krijuar një mekanizëm monitorues me përfaqësues të të gjitha institucioneve të larta të drejtësisë, duke përfshirë këtu edhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të komisioneve të vetëqendrimit, të Ministrisë së Financave, të Prokurorisë së Përgjithshme, të cilët janë pjesë përfaqësuese të mekanizmit monitorues për zbatimin e reformës në drejtësi.

Ju keni të drejtë në shqetësimin që ngrini, pasi çështjet financiare nuk kanë qenë objekt diskutimi i këtij mekanizmi monitorues, sepse ka një organ më të lartë që ndërmerr dhe diskuton politikat, që është Komiteti i Politikave të Drejtësisë, i cili drejtohet nga ministri i Drejtësisë, në të cilin bëjnë pjesë të gjithë përfaqësuesit, të gjithë krerët e institucioneve të pavarura të drejtësisë, por çështjet financiare nuk kanë qenë pjesë e diskutimit të mekanizmit monitorues dhe aq më tepër të një monitorimi sesi është shfrytëzuar pjesa e buxhetit. Kjo edhe për faktin që shpeshherë në mekanizmin monitorues që kryesohet nga Ministria e Drejtësisë janë përfaqësues që nuk kanë lidhje me çështjet financiare. Pra, nuk janë sekretarët e Përgjithshëm apo drejtorët e Financave, por janë punonjës, të cilët raportojnë për sa i përket zbatimit të pjesës së përmbajtjes dhe jo asaj financiare. Duke parë dhe duke pasur parasysh këtë shqetësim, i cili u ngrit edhe në raportimin që kishim në Bruksel përpara një jave në Komisionin Europian lidhur me buxhetin e komisionerëve publikë, i cili kishte vështirësi për shkak të një mungese dhe të përdorimit ashtu siç e përmendi zoti Fino, për shpërblime për këshilltarët. Ishte një çështje ku Ministria e Drejtësisë u vu në dijeni në momentin që ishte përpara përfaqësuesve të Komisionit Europian dhe raportonte për zbatimin e reformës në drejtësi. Prandaj për më tepër përveç pjesës së mbështetjes buxhetore ka nevojë edhe për pjesën e koordinimit ku mekanizmi monitorues në nuklën, e cila është në Ministrinë e Drejtësisë do të ketë më shumë në vëmendje për të qenë më i strukturuar, për të pasur më shumë mundësi të ngritjes së menaxhimit apo të zërave buxhetore dhe financiarë.

Është e vërtetë edhe çështja tjetër që ngriti zoti Fino lidhur me burimet njerëzore të SPAK-ut. Ashtu siç ndodhi me strukturën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të

Lartë Gjyqësor ku në një bashkëpunim me EURALIUS-in dhe me OPDAT-in u përcaktuan strukturat fillimisht, përpara se të ngriheshin institucionet që t'u vinin në ndihmë së bashku me strukturën ndihmëse që të dyja institucionet, këshillat do të kishin nevojë. Përsëri ne patëm një diskutim për sa i përket ndryshimit të kësaj strukture pavarësisht se ishte e rakorduar edhe me partnerët ndërkombëtarë. E njëjta gjë është bërë edhe me SPAK-un, është bërë një parashikim i përafërt për numrin total rreth 115 punonjës së bashku me prokurorët e posaçëm, por me ndryshimet që Këshilli i Lartë i Prokurorisë do t'i bëjë strukturës në varësi edhe të numrit total të prokurorëve që do të jenë fillimisht pjesë e organit të SPAK-ut. Prandaj kërkohet që nëpërmjet mekanizmave monitorues siç është ky që është ngritur në Ministrinë e Drejtësisë të adresohen më mirë të gjitha çështjet që edhe Ministria e Financave të mos gjendet e papërgatitur nga parashikime apo nevoja të ndryshme buxhetore.

E fundit, më 1 janar të vitit 2019 unë nuk e përmenda, sepse e kam thënë disa herë, gjyqtarët u trajtuan financiarisht me dyfishin e pagës. Hyri në fuqi parashikimi ligjor që kishte të bënte me trajtimin financiar me pagë më shumë sesa dyfishi i pagës së mëparshme. Kjo është vërtet një kosto shumë e madhe për buxhetin e shtetit, por duke mbajtur në konsideratë se një ndër arsyt kryesore që u ndërmor kjo reformë është pikërisht për të pasur figura të pastra, me integritet, të pakorruptuara, qeveria e mbështeti, edhe parlamenti që të kishte këtë rritje page dhe të fillonte më 1 janar të vitit 2019, pavarësisht kostos me gati 25% shtesë të buxhetit për vitin 2019 vetëm për rritjen e pagave dhe ngritjen e institucioneve të drejtësisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Jeni dakord me sa parashtruan ministrja dhe relatori. Unë kam vetëm një sqarim më tepër me Ministrinë e Financave apo edhe me Ministrinë e Drejtësisë nëse ka informacionin e duhur. Poli i drejtësisë, godina e re ku do të sistemohen Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Shkolla e Magjistraturës në projektbuxhetin e vitit 2020 është përfshirë si investim, apo është jashtë këtyre zërave buxhetorë?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Vlera e plotë është 19 miliardë euro. Nga Ministria e Drejtësisë do të paguhet rreth 300 milionë, 20% e vlerës, 200 milionë janë sistemimi i IT-së, 140 milionë janë blerje dhe pajisje zyre që bëjnë 640 milionë. Këto janë pjesë që Ministria e Drejtësisë i ka marrë përsipër. Pjesa tjetër do të shikohet në buxhetin e shtetit në vazhdimësi, sepse është një vlerë shumë e madhe. Atje aktiviteti kryhet dhe njihet si kontratë e bërë për të cilën do të likuidohet. Këto janë ndarjet me sa di unë.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Zonja Gjonaj, keni diçka për të shtuar?

Etilda Gjonaj - Kam vetëm diçka të vogël. Për Shkollën e Magjistraturës në vazhden e shpjegimit që dha zoti Fino për polin e drejtësisë, meqenëse është planifikuar që Shkolla e Magjistraturës do të lokalizohet përsëri në një ndërtesë të re, po në këtë territor, është mbështetja buxhetore që ofrohet edhe nga Komisioni European në shumën 5 milionë euro të cilat, do të disbursohen në momentin që projekti do të fillojë.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Ministre!

Duke u bashkuar edhe me sugjerimin e kolegut Fino, por edhe me atë çfarë parashtroi ministrja Gjonaj në komision, në vazhdimësi për vitin 2020 duhet të shikojmë në fillim të vitit, Ministria e Drejtësisë pse jo në bashkëpunim edhe me Kuvendin, Komisionin e Ligjeve ta kemi mekanizmin monitorues të strukturave organizative të organeve të reja të sistemit të drejtësisë që janë krijuar tashmë. Le të themi se nëse Kuvendi po bën një përpjekje për të gjitha institucionet kushtetuese dhe të krijuara me ligj ka një mekanizëm të monitorimit të të gjitha strukturave organizative që ka miratuar Kuvendi për këto institucione, pse jo eksperiencën që kemi ta shtrijmë edhe me institucionet e reja të drejtësisë, organe kushtetuese me struktura me natyrë të përafërt të funksioneve që u kanë ngarkuar Kushtetuta dhe ligji, nuk mund të kenë struktura të ndryshme.

Gjatë këtyre ditëve që kemi pasur dëgjuesat për buxhetin kemi konstatuar se kërkesat kanë qenë të tilla që nuk kanë pasur të bëjnë me funksionalitetin kushtetues dhe ligjor të organit, por kryesisht kanë qenë kërkesa që i referohen trupës ndihmëse të këtyre institucioneve, prandaj pse të mos e kemi këtë bashkëpunim.

Zonja Ministre, ju falënderoj që ishit sot në komision, që bëtë këtë prezantim të detajuar të buxhetit të reformës në drejtësi! Unë nuk dua të shtoj asgjë më tepër nga ato që thatë ju dhe kolegu Fino.

Përsëritës edhe mbështetjen buxhetore që qeveria i ka dhënë Ministrisë së Drejtësisë për luftën kundër korrupsionit. Në mënyrë të veçantë ajo që më bëri përshtypje ishte mbështetja që u jepet ligjeve të reja të reformës në drejtësi që tashmë janë në zbatim e sipër nëpërmjet buxhetimit nga buxheti i shtetit. Këtu dua të veçoj, ashtu siç e thatë edhe ju ligjin për ndihmën juridike, i cili pavarësisht se është pjesë e një plani strategjik edhe me BE-në, ne e kemi vlerësuar që në fazën e draftimit dhe miratimit të tij. Më vjen mirë që Ministria e Drejtësisë në projektbuxhetin e vitit 2020 e ka vënë në qendër të vëmendjes buxhetimin për ligjin për ndihmën juridike, sepse në fund të fundit kjo ka të bëjë me aksesin e qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi në sistemin e drejtësisë.

Ju falënderoj edhe njëherë zonja Ministre së bashku me stafin tuaj!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Shoqatën për Autonominë Vendore dhe Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Bashkim Fino, Elena Xhina, Edmond Leka, Spartak Braho, Andi Permeti, Aurora Mara, Elda Hoti, Nikolin Staka, Xhemal Qefalia, Artemisa malo, Adelina Rista dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Damian Gjikhuri, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Alban Zeneli, Ediola Braha, Adriatik Alimadhi, dhe Tom Doshi

Të ftuar :

Erion Veliaj – Kryetar i Shoqatës për Autonomi Vendore, kryetar i Bashkisë Tiranë
Valbona Sako – zëvendëskryetare e Shoqatës për Autonomi Vendore, kryetare Bashkisë Durrës

Adelina Farrici – Drejtore Ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore

Alketa Daja – koordinatore e financave vendore e Shoqatës për Autonomi Vendore

Jonida Halili – Drejtore e Buxhetit në Bashkinë e Tiranës

Ina Xhepa – Drejtore ekzekutive e Qendrës Europiane

Ulsi Manja - Vazhdojmë me dëgjesën e radhës me Shoqatën për Autonomi Vendore, si dhe me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë.

Të ftuar janë zoti Erion Veliaj kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore, kryetari i Bashkisë së Tiranës, zonja Valbona Sako, nënkryetare e Shoqatës për Autonomi Vendore dhe njëkohësisht kryetare e Bashkisë së Durrësit, zonja Adelina Farici drejtore ekzekutive e Shoqatës për Autonomi Vendore, si edhe stafi që i shoqëron përfaqësuesit e kësaj shoqate.

Dua të vë në dijeni Komisionin e Ligjeve se nga ana e komisionit ka marrë një ftesë për të qenë prezente edhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, të cilën e kryeson kryetarja në detyrë e Bashkisë së Shkodrës, zonja Voltana Ademi. Në vijim të komunikimit që Komisioni i Ligjeve i Kuvendit të Shqipërisë ka pasur me zonjën Ademi, ajo ka njoftuar se për shkak të angazhimeve nuk do të marrë pjesë në mbledhjen e komisionit, por ka dërguar një material në komisionin tonë me shkrim në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2020 për pushtetin vendor. Unë jua kam shpërndarë kolegëve të komisionit.

Pa humbur kohë, jo më kot e kemi organizuar këtë dëgjesë me Shoqatën për Autonomi Vendore, sepse në përbërje të Komisionit të Ligjeve kemi edhe Nënkomisionin për Pushtetin Vendor, që për fat e drejton kolegu Fino, i cili është dhe relator i projektbuxhetit të vitit 2020. Është risi për Komisionin e Ligjeve, që të trajtojmë në kuadrin e diskutimit të projektbuxhetit të vitit 2020 edhe pushtetin vendor si një pushtet shumë i rëndësishëm apo pushteti që është më afër me qytetarin.

Zoti Veliaj, si kryetar i Shoqatës për Autonomi Vendore, por edhe si kryetar i Bashkisë më të madhe, i kryeqytetit, do t'ju ftoja të bënit një prezantim të shkurtër të projektbuxhetit të vitit 2020 për pushtetin vendor. Cilat janë nevojat e këtij pushteti që ju si kryetar i shoqatës keni marrë nga të gjitha bashkitë e Shqipërisë, që tashmë janë pjesë përbërëse e Shoqatës për Autonomi Vendore, po të kemi parasysh se 60 bashkitë sot drejtohen nga kjo shumicë qeverisëse? Sa janë akomoduar në projektbuxhetin e vitit 2020 nga qeveria nevojat buxhetore që kanë bashkitë e Shqipërisë? Cila është mbështetja që si Komisioni i Ligjeve, komisioni përgjegjës Nënkomisioni për Pushtetin Vendor, mund t'ju mbështesim në këtë projektbuxhet derisa buxheti të miratohet edhe në Kuvendin e Shqipërisë?

Fjala është për ju.

Erion Veliaj - Shumë faleminderit, zoti Manja!

E vlerësoj jashtë mase ftesën që i keni bërë shoqatës sonë, e cila është sot shoqata më e madhe në Shqipëri, me 60 bashki të anëtarësuara në Shoqatën për Autonomi Vendore.

Duhet ta pranoj se pas reformës Fino-Çuçi që ridraftoi apo ridizenjoi ndarjen territoriale, kemi pasur lajme, kryesisht të mira nga bashkitë.

Sot shikoj kolegë deputetë, si Xhemali që përfaqësojnë zona rurale, si Kërraba që do t'i duhej mbi 72 vjet të bënte rrugën e Kërrabës që e lidh me autostradën, zonat si Zall Herri që me taksimin e tij do t'i duhej mbi 60 vjet të taksonte, zona si Ndroqi, që vetëm për të bërë urën e Mënikut do t'i duheshin 32 vjet taksime, sot ndodh falë një rishpërndarje.

Unë jam krenar që jam socialist dhe besoj te rishpërndarja, që do të thotë se aty ku ka më shumë pasuri taksat do të përdoren për të mbuluar hendekun në vend që prej dizenjimit të vjetër të sistemit të bashkive dhe të komunave e kishin të pamundur t'i gjeneronin këto të ardhura. Jemi munduar në këta 5 vjet pas reformës Fino-Çuçi që të rikuperojmë këtë hendek, kryesisht me infrastrukturën. Bashkitë janë treguar të zhdërvjellëta në pjesën më të madhe. Dje ne kishim një takim me disa fondacione. Mundohemi që t'i komplementojmë burimet tona apo grantin e qeverisë edhe me donatorë, në shumë prej bashkive si: biznesi privat apo fondacione të huaja, ambasadat janë bërë pjesë e nismave duke filluar nga gjërat elementare, si ndërtimi i kopshteve, shkollave, çerdheve, mbjellja e pemëve dhe gjëra të kësaj natyre.

Jo vetëm kaq, por bashkitë na rezultojnë se pas reformës Fino-Çuçi, të paktën Bashkia e Tiranës ka performuar 2, 9 herë, 3 herë më mirë me buxhetin, edhe pse është shtuar territori, edhe pse janë shtuar përgjegjësitë, edhe pse janë shtuar shpenzimet, edhe pse janë transferuar disa shërbime si ai zjarrfikës apo shërbimi pyjor e të tjera që janë kosto shtesë dhe jo gjithmonë kanë qenë subvencionuar nga buxheti i shtetit. Kjo do të thotë që mbi të gjitha kjo reformë ka qenë një sukses.

Një veçori që do të shtoja, është se përveç punës standard të komplementimit të buxhetit të bashkisë nga granti i qeverisë kemi pasur edhe disa projekte që kanë pasur një injeksion financiar të jashtëzakonshëm te bashkitë, siç ka qenë projekti i rilindjes urbane, ku si unë edhe Valbona kemi qenë përfituesit kryesorë, por besoj se është prekur pothuajse i gjithë territori i bashkisë nga Tamara në Veri deri te Lungo Mare e Vlorës dhe deri në ndërhyrjet në pikat me jugore në Konispol dhe Sarandë.

Përveç projektit të "Rilindjes urbane", tani dua të ndaj komentin tim mbi dy shina: një shinë si kryetar i Bashkisë së Tiranës, që është kryeqytet dhe selia e shërbimeve qeveritare, ajo që quhet shërbimet kryeqytetase për të gjitha institucionet e qendëruara në Tiranë. Pastaj të flas pak edhe në emër të bashkive, por kryesisht në emër të bashkive të vogla që më kanë kërkuar njëzëri që të jemi më të vëmendshëm për nevojat e tyre. Si kryetar i Bashkisë së Tiranës projekti më ambicioz që kemi këtë vit dhe që është propozuar në këtë buxhet, (në

këtë rast dua të falënderoj qeverinë, edhe ju), ka të bëjë me piramidën e Tiranës, e cila është parashikuar t'i fillojë punimet vitin tjetër. Do të jetë një ndërtesë ikonë, që do të jetë investimi kryesor për vitin që vjen. Planifikojmë të jetë një qendër e teknologjisë së informacionit, ku rreth 5 mijë fëmijë, të rinj, nxënës të kenë mundësi të bëjnë kurse të standardeve më të larta ndërkombëtare, kur vjen puna te njohuritë dixhitale, që do të thotë: kodim, dizajn, animacion, robotik, mekatronik, realitete virtuale, realitete të argumentuara, inteligjencë artificiale. Nëse agjenerata para meje mjaftonte të dilte me dhjeta, gjenerata ime të dilte me dhjeta dhe të dinte anglisht, gjenerata e re tani, duhet të dalë me dhjeta, të dijë anglisht, të dijë edhe gjuhën e kompjuterëve. Është kërkuar që qeveria të jetë bashkëfinancuese, bashkëfinancuesi tjetër është Fondi Shqiptaro-Amerikan dhe Bashkia e Tiranës. Qeveria e ka futur në këtë buxhet dhe dua të konfirmoj mbështetjen tonë për këtë projekt.

Janë disa mundësi të shkëlqyera që ne të bëjmë një inovacion pa e prekur paketën fiskale, apo buxhetin e shtetit për disa fenomene apo disa risi që nuk është se ekzistojnë këtu dhe janë para të humbura. Duam të propozojmë TVSH-në zero për autobusët dhe automjetet elektrike. Pra, nuk janë mjete që tashmë qarkullojnë dhe ti po i heq nga bilanci yt. Është diçka që e ka bërë me shumë sukses Norvegjia, miqtë tanë përtej Adriatikut, Italia e ka futur dhe ka shkuar më larg për 5 vjet makinat elektrike nuk paguajnë fare as taksën e qarkullimit. Nuk po them të shkojmë aty, se për sa kohë makina qarkullon janë këto detyrime edhe pse Drejtoria e Qarkullimit Rrugor ka dhënë incentiva për mjetet elektrike me zero ndotje, besoj se do të ishte një risi në Ballkan, do të ishim të parët që e bëjmë këtë gjë. Shqipëria ka një fat që 99.9% të energjisë e prodhon të pastër, hidro. Tani kemi edhe disa projekte që edhe Bashkia e Tiranës, por edhe qytete të tjera po përfshihen në energjinë solare. Ne kemi planifikuar që me disa nga kompanitë kryesore botërore me famë për energjinë solare të kthejmë një pjesë të liqenit të Bovillës. Energjia solare ka një kosto të lartë kryesisht prej terrenit dhe tokës. Kur je kryeqytet dhe metri katror vlen shumë, nuk mund të mbulosh hapësira të tjera me ferma solare. Ideja inovatore për të përdorur të njëjtin liqen që sipër prodhon energji dhe poshtë ujë për qytetin na duket brilante, por që ta mbyllim këtë cikël duhet që edhe konsumi i kësaj energjie të përfundonte i pastër kur vjen puna te mobiliteti dhe lëvizshmëria. Propozojmë, edhe me një kërkesë të shumë operatorëve që janë gati të transformojnë linjat e tyre në linja elektrike, por ende çmimi i një mjeti elektrik është prohibitiv, pra bie më lirë me dizel, me naftë, por që është i vetmi faktor ndotës. Në Tiranë dhe në Durrës nuk kemi as fabrika, as uzina, as termocentrale, as digjet qymyr, por ndotja na vjen vetëm nga makinat dhe nëse me këtë propozim çmimi i një makine elektrike do të ishte sa çmimi i një makine dizel, fare mirë dhe me incentivat që ne si qytet kemi dhënë për karrikimin. E provuam me taksitë dhe kemi

sot një situatë ku gjysma e flotës së Tiranës po shkon në elektrike, vetëm se bashkia uli burokracinë, në vend që dikush të presë për një licencë elektrike 5-6 apo 7 vjet sa të lirohet 1 nga 1 mijë se është me numër fiks, sipas banorëve, ne e japim në 24 orë nëse vjen me mjet elektrik. Po të jepnim incentivë të ngjashme tani edhe për qytetarët e thjeshtë apo për bizneset që autobusët dhe makinat elektrike t'i kishim pa TVSH, besoj se do të ishte një lajm jashtëzakonisht i mirë. E njëjta gjë është për TVSH-në e reduktuar 6% siç kemi bërë për turizmin, te biletat e transportit urban nëse mjeti është elektrik. Është e vetmja mënyrë sesi del fizibël ky transformim. Do të ishim të partë në rajon me diçka kaq inovatore kur vjen puna te çështjet e mjedisit.

Kemi pasur një angazhim dje të qeverisë që të reflektojë kontributin e saj kur vjen puna te impianti i përpunimit të mbetjeve të Tiranës. Kemi dakordësuar me qeverinë sesi do ta bashkëfinancojmë pjesën e rikuperatorit të energjisë. Tirana falë kësaj iniciative të Kryeministrit dhe të qeverisë shpëtoi nga një *landfill* ku digjeshin plehrat dhe era e tymi në zonën e Sharrës e të Kombinatit ishte e papërballueshme, kështu që ka ndodhur inkapsulimi i landfillit. Tani fillon faza e dytë, ajo e ndërtimit të rikuperatorit të energjisë, kur ne kthejmë energjinë e mbetjeve në energji termale, edhe në avull për serrat e gjithë zonës Ndroq – Vaqar e të Tiranës rurale.

Dje kemi dakordësuar me qeverinë në lidhje me faturat. Qeveria do të jetë diku në nivelin 600 milionë lekë, ndërsa bashkia e Tiranës në nivelin 470 milionë lekë, ndërkohë që angazhimi që i kam bërë Kryeministrit dhe qeverisë, sipas skedulës së pagesave, është që qeveria do të vijë duke e ulur gjithnjë e më shumë kontributin, ndërsa bashkia do të vijë duke e rritur kontributin, që pastaj qeveria t'i implementojë këto financa në një bashki tjetër, e cila mund të ketë nevojë për të njëjtën zgjidhje, siç e kanë bërë Elbasani, Tirana dhe Fieri.

Ndërkohë, ajo që kërkojmë, e që do ta kërkojmë edhe në Komisionin e Ekonomisë, si projekt i Tiranës, ka qenë bashkëfinancimi i projektit të lumit të Lanës. Pavarësisht pengesave që na u krijuan nga disa institucione jashtë kësaj maxhorance qeverisëse për të mos negociuar një kredi me BEI-n, bankë e Bashkimit European, pra Banka Europiane e Investimeve, arritëm ta kalonim me sukses këtë sfidë, e si rrjedhojë Banka Europiane e Investimeve ka vendosur të financojë kredi prej 8 milionë eurosh, si dhe t'i japë 3 milionë euro grant bashkisë së Tiranës për lumin e Lanës dhe zgjatimin në drejtim të Kasharit.

Pra, jo vetëm që kemi një kredi super të butë me *great spirit*, me afat pagese të shtyrë me vite, pra që nuk fillojmë të paguajmë deri pas pesë vjetësh, ndërkohë që 3 milionë i kemi grant. Pra, praktikisht, bashkia po fiton. Pavarësisht interesit dhe pagesës, praktikisht është si para falas.

Ka qenë këmbëngulja e tyre që ta pilotojnë në Tiranë kredidhënien dhe grantdhënien, direkt në një autoritet lokal, dhe nëse do të rezultojë e suksesshme në Tiranë, do të vazhdohet dhe me bashkitë e tjera. Ne duam të reflektohet si angazhim për vitin e parë dhe vitin e dytë të investimit; bashkia e Tiranës me Bankën Europiane të Investimeve është e përgatitur ta fillojë vetë projektin, por do të duhet të reflektohet në planin buxhetor trevjeçar, pra afatmesëm, që si investitori, si bashkia të kenë garancinë se edhe qeveria do t'u përgjigjet siç është dakordësuar deri tani në negociatë.

Tani do të doja të flisja pak si përfaqësues i bashkive të vogla të republikës sonë. Më vjen mirë që edhe Frani është këtu, për të adresuar disa nga çështjet, të cilat në fakt janë vetëm zbatim i ligjit. Pse them: si përfaqësues i bashkive të vogla? Them sepse shumë prej jush i përfaqësoni këto bashki dhe jeni të ndjeshëm për disa gjëra.

Së pari, ne kemi kaluar në këtë parlament një ligj, ligji 68/2017, neni 25. Në ligjin "Për taksat kombëtare" është vendosur të ndahet me njësitë e qeverisjes vendore tatimi mbi të ardhurat personale, për secilën njësi të qeverisjes vendore që përfiton 2 % të të ardhurave të realizuara. Pra, nga gjithë tatimi i të ardhurave, 2 % i shkojnë bashkisë në të cilën janë gjeneruar këto të ardhura. Ligji ka hyrë në fuqi me 1 janar 2018. Nuk janë transferuar këto, as te 2028-a e as te 2029-a, por duam që në 2020-ën duhet të ndodhë, sepse paratë janë. Nuk po kërkojmë gjëra shtesë, por vetëm të zbatohet ligji që e kemi bërë vetë.

Pse them: i bashkive të vogla? Për bashkinë e Tiranës e të Durrësit, se erdhën 500 mijë euro, se erdhën 1 milion, se s'erdhën fare këto, nuk lëviz asgjë, sepse janë bashki të stërmëdha. Nuk do të bëjmë pesë shkolla, do të bëjmë katër e gjysmë. Për një bashki si ajo e Librazhdit, e Roskovecit, si e Memaliajt, si Divjaka, së pari, kjo parë është e qenësishme. Një bashkie të vogël, 200 mijë euro i bënë shumë punë, sepse edhe gjërat kushtojnë më pak, që do të thotë se edhe shërbimet i ofron me një kosto më të ulët. Jo vetëm kaq, por humbet incentiva e një kryetari bashkie, që të krijojë vende pune, për sa kohë që punën e bashkisë nuk e lidh fare me këto vende pune që janë krijuar. T'i thuash një kryetari bashkie: "shko e kape për mënge atë sipërmarrësin", "rriju printo atij të huajt", "ofro çfarë ke nga ato kapanonet e shkatërruara, që s'po i përdor njeri" etj... Të krijosh incentiva, sepse një dypërqindësh të çdo rroge që del këtu, do ta marrësh ti, si bashki, që të bësh më shumë infrastrukturë, incentiva e një kryetari bashkie rritet në mënyrë eksponenciale. Do të jenë tërë kohën në çdo forum biznesi dhe do të bëjnë qepaze që çdo biznes të vijë në Memaliaj, të vijë në Konispol, të vijë në Këlcyrë, të vijë në Has, të vijë në Fushë-Arrëz. Bulqiza jeton vetëm me miniera, Fushë-Arrëzi vetëm me minierën e bakrit dhe për sa kohë që burimin kryesor të rrogave e kanë aty dhe për sa kohë nuk sheh asnjë lidhje, çfarë interesi kanë t'i bëjnë rrugën minierës, çfarë interesi kanë t'u çojë autobusin,

çfarë interesi kanë t'u bëjnë një çerdhe afër vendit të punës, sepse s'e shohin fare të lidhur suksesin e atij biznesi me suksesin e punës së tyre si kryetarë bashkie.

Duam që kjo të adresohet në 2020-ën, dhe paratë e prapambetura të këtyre tre viteve, që janë në llogari të Ministrisë së Financave, t'u kalojnë bashkive.

E thashë, jam kail të them: mos na i sillni neve, por të paktën mos ua mbani atyre, se realisht janë maskë oksigjeni ato bashki. Unë s'jam naiv, sepse indirekt kam interes, sepse çdo njeri që nuk gjen shpresë në këto bashki të vogla, vjen në Tiranë dhe në Durrës. Kështu, në njëfarë mënyre, herët a vonë, po nuk reflektoam, kjo do të kthehet në një barrë. Nëse kemi interes mosshpopullimin e këtyre zonave, minimalisht duhet ta zbatojmë, që kësaj maske oksigjeni të mos i pritët tubi, por të shkojë deri në fund.

Ndërkohë, një tjetër çështje me shumë interes. Në nenin 23 të po këtij ligji, është vendosur nga ky parlament, nga kjo shumicë, që granti i pakushtëzuar i njërive vendore, do të jetë 1 % e GDP-së. Për sa kohë që ne e dimë se sa është prodhimi i brendshëm bruto, është vetëm 1 % e asaj. E kemi respektuar në 2018-ën, e kemi respektuar në 2019-ën, e kemi respektuar edhe në 2017-ën, kur sa kishin hyrë në fuqi aktet e reformës Fino-Çuçi, ndërkohë që për 2020-ën nuk e kemi respektuar. Do të doja të respektohej. Nuk është diferencë e madhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e di edhe shumë ekzakte se sa është. Nëse keni ndonjë më të azhurnuar... Tani, do të doja ta respektonim, prapë po e them, për bashkitë e vogla. Për bashkitë e vogla, ai granti është gjithçka. Për mua, për Durrësin, për Elbasanin, për qytetet e mëdha, granti është mbase tek zërat e fundit. në qytetet e mëdha, ku ndërtohet, taksa e ndërtimit... Në qytetet e mëdha, ku ka prona, ku prona ka vlerë, taksa e pronës vjen e dyta. Pastaj vijnë shërbime të tjera, që marrin nga taksat. Për mua, si bashki e Tiranës, granti është një nga gjërat e fundit, kur vjen puna tek të ardhurat. Për bashkitë e nivelit të dytë dhe nivelit të tretë, është zëri numër një. Kjo do të thotë se edhe diçka modeste, në këto bashki ka influencë.

Kësisoj, do të doja shumë që të respektohej ligji 100 %. Pra, në qoftë se kemi thënë 1 %, duhet të jetë 1 %, që këtyre bashkive të vogla të mos ua vëmë lakun. Prapë them: e kemi interesin indirekt. Nëse në bashki të vogla jetohet mirë, kjo është një arsye më shumë që të mos vazhdojë të shtohet Tirana. Kur unë te kem mbaruar këtë seancë dëgjimore sot, Tirana do të jetë shtuar me tetëdhjetë vetë. Aq është numri.

Unë i dëgjoj të gjitha shqetësimet: trafiku, ndërtimet, por si t'ia bëjmë? Tirana shtohet çdo ditë me 80 vetë. Në fund të vitit, kur themi: "Gëzuar Vitin e Ri!", Tiranës do t'i jenë shtuar 25 mijë vetë.

Çfarë t'u themi këtyre? Rrini nën ura? Rrini te Lana? Shkoni e ndërtoni pa leje te liqeni? Çfarë do të bëjmë?

Pra, ne detyrohemi të shtojmë urbanistikën në qytet, se shtohet trafiku. Në orën 8 të gjithë duan të shkojnë në punë. Kujt do t'i thuash: rri në shpi, që unë ta kem trafikun të lirë?

Pra, pakti që bëjmë, kur duam të jetojmë të gjithë në Tiranë, është se do të bashkëjetojmë me 1 milion të tjerë, në të njëjtën infrastrukturë që është bërë për 200 mijë vetë.

Tani, një mënyrë për ta frenuar këtë, është të fuqizojmë bashkitë e vogla. Nuk po u hyj fare disa kërkesave tjera që kanë bërë ata me rentën minerare. Në fakt, kanë një lloj të drejte. Jetojnë shumë afër pasurisë, e cila vilet këtu, por pak shkon atje, por minimalisht t'ua respektojmë këto dy gjëra: dypërqindëshin e tatimit mbi të ardhurat, dhe njëpërqindëshin e prodhimit të brendshëm bruto. Kështu që, e vlerësoj jashtë mase këtë.

Në qoftë se më lejoni, i nderuari kryetari Manja, dua të shtoj vetëm dy gjëra të vogla, të cilat nuk kanë të bëjnë me buxhetin, por kanë të bëjnë me disa nisma, që ne do të vijmë t'i adresojmë para jush.

Njëra do të jetë një nismë, të cilën do ta sjellim nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, me një korrektim, një ndryshim të kufijve territoriale të bashkive. Reforma Fino – Çuçi ka adresuar 99, 99 % të shqetësimeve. Megjithatë, duke qenë se ishte voluminoze, kanë lindur disa probleme, të cilat duhet të kenë një rishikim të korrektimit të kufijve. Në disa raste, kur në një territor ku duam të bëjmë një shkollë qëllon vija nga ana tjetër. Pra, janë gjëra krejt banale. Disa gjëra, pastaj, më duken parimore.

Do t'ju sjell një shembull konkret, në lidhje me të cilin kam marrë edhe dakordësinë e Kryeministrit e të qeverisë, dhe do të doja që, kur t'ju vijë këtu, të jeni të përgatitur.

Nuk mundet që, aeroporti ndërkombëtar i Shqipërisë, i Tiranës, të vazhdojë të jetë më në Fushë-Krujë, dhe nuk mundet që rruga lidhëze të jetë në Vorë. Vetëm segmenti Qafë e Kasharit, ku mbaron kufiri i Tiranës e deri te rrethrotullimi i Rinasit, ka 192 çarje të paligjshme në rrugë.

Për bashkinë e Vorës, nuk ka rëndësi fare se kush është kryetar bashkie, për bashkinë e Krujës, nuk ka rëndësi fare se kush është kryetar bashkie, Rinasit është në periferi të vëmendjes së vet. Është në periferinë e vet fizike, dhe është në periferinë e vet të mundësive. Kjo do të thotë: të kenë policë bashkiakë, të kenë IMT, të ruajnë çdo njeri që zaptot aty.

Siç e keni vënë re, së bashku me ARRSH-në, morëm përsipër një aksion, që e kanë drejtuar vetë, por në të zezë, për të bllokuar hyrje-daljet. Tani, imagjinojeni: ne duam të futemi në Bashkimin European, por vjen një i huaj, zbret në Rinas, ndoshta i dërguar nga qeveria e tij, që të shohë se sa jemi gati, dhe gjëja e parë që sheh, është se ne nuk kemi dot integritet rruge

Rinas-Tiranë. Pra, vjen një delegacion VIP, q ë të takojë parlamentin, dhe nga rruga Rinas – Tiranë shikon se është si në Kabul.

Kështu që, kjo mund të bëhet në të zezë deri në njëfarë mase, por unë nuk investoj dot më, që të bëj pemë, të bëj gardrele, të çoj shërbime të Policisë Bashkiake të IMT-së, në një territor që s’është imi, sepse është shkelje. Është shkelje, pavarësisht se ju thoni se po e bëj për mirë, sepse aeroporti i Tiranës, por realiteti është ky.

Nga rrethrotullimi i Rinasit e deri te Hertz-i, janë pesëdhjetë çarje që kemi mbyllur, por që janë të gjitha në Fushë-Krujë, dhe Fushë Kruja nuk ka mundësi as me mjete e as me polici, që të rri e të ruajë non stop abuzimet ë bëhen aty. Kështu, kur zbret në Rinas, të duket sikur ke zbritur në një varrezë të madhe makinash: lavazhe, gomisteri, koka varresh, për njerëz që mund të jenë aksidentuar dhe kanë humbur jetën, restorante, ele, traktorë të prishur, mullarë, çarje mu në mes të rrugës, bagëti që kalojnë.

Po të isha përfaqësues i Komisionit European, do të thosha: “çuna të mirë, po kur s’ruajnë dot një rrugë...”

Kjo zgjidhet ndryshe. Nuk mund të ruajë qeveria rrugët, nuk mund t’i ruajë parlamenti rrugët. Kjo zgjidhet kështu: i jepet bashkisë që ka emrin e aeroportit. Një korrektimi të tillë, kur i kemi edhe fuqitë financiare, edhe fuqitë njerëzore për ta bërë, i ka ardhur koha.

Ajo që është më e rëndësishme, besoj unë, është se vitin tjetër do t’ju vijmë prapë me një propozim, sigurisht në këtë komision, dhe është një ligj për Tiranën. Ka një ligj për Parisin, ka një ligj për Romën, Roma *capitale*, ka një ligj për Londrën, ka edhe një ligj për Prishtinën. Imagjinoni: Prishtina, shtet i ri Kosova, një dekadë shtet, ka një ligj për kryeqytetin.

Konsumi në kryeqytet është shumë më i madh se konsumi në një qytet tjetër. Fjala vjen, po vijnë festat, të gjithë vijnë në Tiranë. Dikush vjen te Gjykata e Lartë, te Gjykata Kushtetuese, dikush vjen te një spital kryesor, dikush vjen këtu, në parlament. Pra, ka konsum fizik të Tiranës. Kur buxhetoren rrugët e Tiranës, buxhetoren për banorë. Në të vërtetë, duhen buxhetuar për përdorues, që janë më shumë se sa banorët.

Kështu që, është shumë e rëndësishme të kemi një ligj të veçantë për kryeqytetin. Siç është Roma *capitale*, duhet të kemi edhe një: Tirana kapitale. Duhet të themi se shërbimet që ofron Tirana si kryeseli e qeverisë, e shtetit, e gjykatave, e të gjitha institucioneve qendrore, ka një kosto, e cila nuk llogaritet dot më për banorë, po për përdorues.

Kemi marrë disa modele shumë të mira, dhe besoj se ka ardhur koha t’i adresojmë disa nga këto gjëra. Pra, duke filluar nga kufijtë e Tiranës, kur zbret si zotni në aeroport dhe shikon civilizim european, derisa vjen në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” dhe takon përfaqësuesit e shtetit në parlament apo nëpër ministri, dhe pastaj të gjitha shërbimet e tjera, që duhet t’u

ofrohen qytetarëve, që kur të vijnë në Tiranë, të reflektojnë realisht dinjitetin e kombit tonë, është kartolina e Shqipërisë. Nëntëdhjetë për qind e Shqipërisë, nëntëdhjetë për qind e atyre që zbresin në Rinas, vijnë në Tiranë. Pra nëntëdhjetë për qind e atyre që vijnë për turizëm, patjetër që kalojnë në Tiranë.

Kësisoj, për të gjitha këto arsye, edhe për faktin se nesër presim një vendim shumë të rëndësishëm: Tirana është listuar si një nga pesë qytetet finaliste për t'u përzgjedhur si kryeqyteti evropian i rinisë në vitin 2022. Nesër në Francë presim një rezultat. E filluam garën me pesëqind qytete europiane, që u reduktuan në 100, më pas në 50. Më pas, ne u listuam te pesë të parët, kur patëm intervistat finale në Bruksel. Nesër shpresojmë shumë. Kjo do ta sillte Tiranën në qendër të vëmendjes. Ama, nëse ne nuk rregullojmë imazhin e parë, sa zbret në Tiranë, apo shërbimet që ofrojmë në këtë qytet, në vend që kjo të jetë një mundësi, mund të na kthehet në bumerang.

Kështu që, do të doja shumë që t'i adresonim përpara se të bëhemi gati. Vitin tjetër Tirana mbush 100 vjet, mbush shekullin e parë si kryeqytet, ndaj është shumë e rëndësishme që, më në fund, të ketë një ligj. Edhe parlamenti mbush 100 vjet, kështu që e kemi një të mirë që na ka ardhur nga Kongresi i Lushnjës, më 1920. Do të donim që ai vit jubilar të përkthehej edhe në një vit domethënës, kur vjen puna te legjislacioni për Tiranën. Pas 100-vjetorit të Tiranës, të shpresojmë me gishtat kryq nesër, që të mund të jemi kryeqyteti evropian i rinisë, gjë që do ta kthente realisht në vlerësimin më të madh botëror, ose të këtij kontinenti, që mund të ketë marrë ndonjëherë qyteti ynë.

Kësisoj, mezi pres të gjej bashkëpunimin tuaj për këto tema.

Shumë faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Veliaj!

Në fakt, të dy këtyre projektligjeve, që ju thatë se do të vinë vitin tjetër në parlament, qoftë ligji për korrektimin e kufijve, qoftë ligji për kryeqytetin, e shoh se u ka ardhur koha, sepse pashë Xhemalin që luajti kokën dhe tha se duhej të kishin ardhur me kohë.

Shumë faleminderit edhe një herë!

Zoti Fino, lidhur me projektbuxhetin e pushtetit vendor për vitin 2020. Cilat janë gjetjet në këtë projektbuxhet, dhe si e konsideroni ju buxhetin për pushtetin vendor, në lidhje me të cilin, për hir të së vërtetës, zoti Veliaj, duhet thënë se zoti Fino është avokati më i madh i pushtetit vendor në Komisionin e Ligjeve e në Parlamentin e Shqipërisë, sepse në fund të fundit ka qenë kryetar bashkie, por edhe ligji “Për pushtetin vendor” ka autorësinë e zotit Fino e të kolegut Çuçi.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Në fakt, unë e kam shumë të thjeshtë të falënderoj kryetarin e bashkisë së Tiranës, kryetarin e bashkisë së Durrësit, Adelinën si drejtoreshë. Falënderoj edhe shoqatën tjetër të bashkive për materialin që ka sjellë, material të cilin e kam lexuar me vëmendje, kam mbajtur shënimet përkatëse dhe do ta adresoj të gjithë problematikën.

Për hir së vërtetës, të dyja materialet janë pothuajse njësoj, sa u takon problematikave që ngrenë. Materiali juaj dhe materiali i shoqatave nuk kanë ndonjë diferencë.

E vërtetë se lufta pushtet vendor dhe pushtet qendror, pavarësisht se kush është në qeveri, është e vazhdueshme, gjë të cilën e kam provuar me kurriz qoftë kur kam qenë kryetar bashkie, qoftë kur kam qenë ministër i Pushtetit Vendor.

Zoti Veliaj tha disa nga gjërat, pasi ka shumë gjëra të tjera ku ka probleme, por në fund të fundit, fatmirësia jonë është se i kemi kaluar të dyja këto faza. Kryeministri ynë ka qenë edhe kryetar bashkie, kështu që e njeh problematikën e qeverisjes vendore. Edhe porositë për këtë buxhet kanë qenë të zbatueshme, në njëfarë mënyre, dhe kanë ecur drejt, por e kam thënë edhe herë tjetër se buxheti është si puna e dasmës: i fton të gjithë, mund të mos ftosh dy-tre vetë, e atyre u ngelet qejfi.

Edhe sikur buxheti për pushtetin vendor të ishte më shumë, ju nuk do të thoshit: pse na dhatë kaq shumë? Natyrisht, kërkohet më shumë, por kjo varet nga mundësitë e shtetit, të Ministrisë së Financave, të ardhurave e kështu me radhë.

Rëndësi kanë dy shtyllat ku mbahen. Siç tha edhe zoti Veliaj, është e vërtetë, unë i kam shifrat më të sakta. Gjithsesi, ne Komision i Ligjeve, do t'ia relatojmë Komisionit të Ekonomisë, kur të bëjë përmbledhjen. Absolutisht, ne nuk e kemi bërë kot ligjin e financave vendore. Ligjin e financave vendore e kemi bërë pikërisht për këtë gjë, dhe kemi fituar një status të rëndësishëm. Kjo është meritë edhe në kuadrin e nënshkrimit të autonomisë vendore, 1 % e transfertës së pakushtëzuar do të jetë baras me GDP-në. Këtë pothuajse e kemi respektuar. Madje, zotërinj kryetarë të bashkive, në debatin që kam bërë para katër-pesë ditësh këtu me ministren e Financave, debati im ka qenë ndryshe. Ka qenë: ju e respektoni njëpërqindëshin, por ne duhet të afrohem brenda rajoneve të Ballkanit. Ka vende në rajonin tonë, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Kosova, të cilat e kanë mbi 1 %, e kanë 2 %, 3% të GDP-së transfertën e pakushtëzuar. Kjo do të thotë se ne duhet t'u afrohem atyre, për ta rritur këtë.

Domethënë, që ta kuptojnë kolegët e mi, njëpërqindëshi është dyshme. Poshtë këtij njëpërqindëshi, Ministria e Financave, sa herë që të paraqesë buxhetin e shtetit, nuk ka të drejtë ta ulë më poshtë. Na dha 1, 1, na dha 1, 5, na dha 2 %, kjo është gjë pozitive, sepse u afrohem vendeve të rajonit.

Kjo është kërkesa që unë personalisht, si relator, i kam bërë ministres së Financave. Natyrisht, në relacionin tonë, do të shikojmë edhe një herë përlllogaritjet, mua më dalin tamam këtu, me 1 %, që të jetë 1 %.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

Erion Veliaj – Arsyeja pse nuk na dalin llogaritë njësoj, ka të bëjë me faktin se Ministria e Financave llogarit edhe qarqet te ky buxhet. Kije parasysh se 90 % e buxhetit të qarkut të Tiranës e jap unë me kontribut. Kjo do të thotë se, po futët dhe këtë, hajde të fusim edhe shoqatën e bashkive, që prapë ne të dy e mbajmë me kontribute, pasi ne jemi dy bashkitë më të mëdha, e po ashtu dalim mbi 1 %. Pra, nuk mund të numërojmë qarqet, të cilat i paguajmë po ne.

Më mirë të themi: nuk e kapim dot këtë vit, gjë që është më e mirëkuptueshme, se sa të bëjmë këto hilet e bardha, sepse nuk shkon. Nuk mund të llogariten qarqet tek ajo. Prandaj ne të dy kemi një diferencë në llogari, sepse themi: kjo është për njësitë vendore, jo njësi të tjera, të rrjedhura nga shoqata, qarqe, bashkëpunime. Për këtë jam dakord, 1 % është baza. Edhe ky njëpërqindësh, kur ndahet diskriminon bashkitë e mëdha. Pra, jam shumë i sigurtë në lidhje me këtë. Pra, mënyra si ndahet fillimisht granti – ju e dini formulën e famshme të USAID-it – fillimisht ndahet në proporcion me popullsinë, por më pas balancohet me aftësinë mbledhëse të njësive. Kjo do të thotë se më pas, më të voglat marrin disproportionalisht më shumë.

Kështu që, po të jetë për ne të dy, ne me qarin jemi. Ndërkohë, për bashkitë e vogla, që tashmë favorizohen nga mënyra si ndahet granti, të paktën të jetë njëpërqindëshi, pa llogaritur qarqet, ju lutem.

Bashkim Fino – Absolutisht dakord! Nuk ka pse të përlllogaritet transferta, pavarësisht se shifra e qarqeve është e papërfillshme, por gjithsesi, unë isha duke thënë se në relacionin që do të bëjmë, natyrisht që do të mbështetemi te ligji i financave vendore, që të jetë patjetër 1 % e GDP-së, dhe kjo është shumë e saktë.

Nga ana tjetër, çfarë kam kërkuar unë, në funksion të atyre që thatë ju. Unë kam kërkuar nga Ministria e Financave... Jam në një mendje me ju, dhe nuk e kam për bashkitë e mëdha, siç thatë ju. ka ca borxhe të trashëguara. Kur bashkë me kolegun Çuçi bëmë reformën territoriale, kishim 383 njësi vendore, që i bëmë 61. Mund t'i bënim edhe më pak, por ashtu u vendos. Natyrisht, shumë nga këto njësi të vogla, ish-komunat e vogla, kanë pasur borxhe të trashëguara, borxhe të cilat i trashëgoi bashkia e madhe, si territor, si njerëz e të tjera me radhë. Fakti se nga 13 miliardë, ai është ulur në 6, 2 dhe 6, 7 miliardë deri në këto momente, flet për punën e mirë që kanë bërë bashkitë e mëdha, me performancën e tyre, edhe për shkak të

avantazheve që ne u kemi krijuar, të cilat ju i thatë, ndaj s'dua të ndalem. Gjithsesi, edhe si kryetar i nënkomisionit, i kam kërkuar Ministrisë së Financave, që pse të mos ketë një amnisti për pushtetin vendor, sidomos për të zeruar investimet që kanë të bëjnë me FZHR-në, me FZHZH-në, të cilat janë mundësi dhe borxhe të vjetra. Nuk po flas për borxhin e ri që mund të krijojë një bashki e re në këto momente, se i dalin për zot vetë, por po flas për borxhe tejet të vjetra, që i kanë kaluar me atë reformë të re territoriale, sepse në fund të fundit, ti vërtet ke trashëguar, siç i more si shembull, edhe investimet që ke bërë në zonën e Xhemalit apo në zona të tjera rurale, por bashkitë e tjera kanë trashëguar një borxh, i cili duhet të konsiderohet.

Së dyti, kam kërkuar me forcë dhe do ta kërkoj edhe në relacion për Ministrinë e Financave dhe sidomos tek Ekonomia.

Ju kam ndjekur me vëmendje para disa kohësh dhe jam një nga kritikuesit më të mëdhenj të sistemit të pagave dhe të piramidës së pagave në tërësi. Janë 6 kategori pagash në bashki. Pra, çfarë do të bëjmë ne? Ne bëmë një reformë territoriale dhe nuk e shoqëruam atë reformë territoriale me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, që të ishte funksionale për këtë reformë të madh dhe për këto bashki të mëdha. Sot ne nuk mund të mbajmë 6 kategori pagash.

Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme duhet të paraqesin një draft me 2-3 kategori pagash, që të ndihen mirë këshilltarët, nëpunësit, punonjësit, se ne jo pa qëllim e bëmë këtë reformë, Ne e bëmë edhe për fuqinë intelektuale të njerëzve, ku në një komunë me 500-1000 veta nuk mund të gjeje dot një arkitekt, nuk gjeje dot një inxhinier të thjeshtë, pale të gjejë arkitekt.

Me këtë ndarje që kemi bërë do të thotë që ne duhet t'i stimulojmë këta njerëz që vijnë të punojnë. Ata duhet të vijnë të punojnë dhe të ndihen mirë, të punojnë për qytetin e tyre, por të jenë edhe të paguar, në fund të fundit.

Çështja tjetër që kam trajtuar dhe që kërkoj me insistim, është për ligjin e mëparshëm (kam bërë edhe një debat kur isha në opozitë me Kryeministrin Berisha). Ka qenë 25% renta minerare dhe është një rentë që duhet shfrytëzuar nga organet e pushteti vendor. Sot e kemi 5% dhe është shumë mirë, se 25% ishte një shumë e jashtëzakonshme, që një bashki po të merrte 25% të rentës minerare nuk kishte nevojë për grantin e pakushtëzuar. Ama, në qoftë se sot e kemi në ligj 5%, ligji të zbatohet. Ne vuajmë nga moszbatimi i disa ligjeve që kemi bërë vetë. Në qoftë se ne do të zbatojmë ligjin, 1% të GDP-së, 5% të rentës minerare, të jeni të bindur që ka mundësi t'u kërkojë llogari bashkive për performancën e tyre, se nuk kanë nevojë të kërkojnë shumë nga qeveria apo nga buxheti.

Në rastin konkret ky 5% është i domosdoshëm, sepse është e vërtetë që zona të caktuara kanë mundësi dhe miniera, por ka të tjera që nuk kanë dhe rishpërndarjen e bën shteti dhe shumë mirë që e bën shteti.

Në qoftë se ligji thotë që 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale do t'i kalojnë pushtetit vendor, kjo është taksative. Ti nuk ke asnjë të drejtë të mos e kalosh këtë 2% tek organet e pushtetit vendor. Ligji ka hyrë në fuqi dhe është ekzekutuar.

E fundit dhe shumë e rëndësishme është që të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që vijnë këtu për organet e pushteti vendor, funksione të deleguara apo të dhëna duhet të shoqërohen patjetër me numër punonjësish dhe me faturë financiare. Ky ka qenë një handicap i të gjitha qeverive, që gjithmonë i janë dhënë funksione pushtetit vendor dhe nuk i janë dhënë faturat përkatëse. Neve na takon të bëhemi barrikadë, që çdo faturë financiare duhet të jetë e lidhur dhe t'i shkojë pushtetit vendor si mundësi për ta trajtuar atë gjë.

Unë dhe Çuçi jemi shumë korrektë që ajo ndarje territoriale është nga më të mirat që është bërë dhe është një nga reformat më të mira që ka bërë qeveria "Rama1", por në momentin kur e kemi bërë, ne kemi vërejtur se ka disa nevojë për disa korrektime (për shembull, ka korrektime në bashkinë e Durrësit). Unë do të doja dhe jam i gatshëm të jap disponibilitetin tim që ta sillni këtë projektligj, t'ju ndihmojmë edhe ne për ta kaluar dhe për ta bërë, sepse edhe ne jemi të ndërgjegjshëm që duhet të bëhen disa korrektime.

Është me 84 vota. Mirëkuptimin e opozitës e kemi, sepse janë gjëra teknike dhe nuk ka gjë politike në mes. Territori është ai që është dhe ne nuk do të bëjmë rishikim të territorit, por do të rishikojmë vetëm gjëra të vogla, ashtu siç ligji për kryeqytetin e kanë të gjitha vendet. Mbase tani është momenti për ta bërë një gjë të tillë dhe ju shumë mirë që e ngrini si problem.

Në përfundim, unë do të rikapituloja 2-3 momente kryesore:

- Në relacionin e Komisionit të Ekonomisë të jemi striktë nga pikëpamja absolute e 1% e GDP-së të transfertës së pakushtëzuar.
- Do të jemi striktë për 2%-shin e të ardhurave personale që duhet automatikisht të kalojë, duke zbatuar ligjin.
- Çështjen e taksës, sidomos e rentës minerare, si dhe kategorizimit të pagave ne ta vëmë në relacion se relacionet tona janë udhëzuese për punën e ministrave për buxhetin e vitit 2020.

I falënderoj të dy kryetarët që ishin këtu! Falënderoj Shoqatën e Bashkive! Falënderoj gjithë komisionin për punën e lodhshme që kemi bërë gjatë këtyre 4-5 ditëve!

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Veliaj!

Erjon Veliaj – Kam një sugjerim për çështjen e pagave. Mund të ishte një projekt që qeveria e ka zbatuar me shumë kreativitet për mjekët. Sot është e pamundur të marrësh një arkitekt apo një urbanist të mirë nga Tirana dhe ta çosh në Fushë- Arrëz apo Tropojë (se rroga është 300 mijë lekë dhe kjo të shkon veç për transport). Të gjithë duan rroga më të larta, por në pamundësi që kjo të bëhet universale, ndoshta me kryetarët e bashkive të kategorisë së tretë dhe të dytë, kjo gjë të ushtrohet vetëm për disa profesione që janë më specifike.

Ne mund të vijmë me një propozim pak më modest për rritjen e pagave, ku themi: adresojmë vetëm bashkitë e vogla për x numër kategorish (urbanistë, inxhinierë ujrash apo 2-3 fusha ku e kanë shumë të vështirë të bindin dikë që të vijë nga Tirana). Kjo mendoj se e zgjidh këtë emergjencë.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Së pari, ne ramë dakord që në raportin që do t'i çojmë komisionit përgjegjës, që është Komisioni i Ekonomisë, t'i adresojmë të gjitha ato që tha relatori, zoti Fino, por unë desha ta di se pse nuk është bërë deri tani një gjë e tillë. Nëse thuhet se 2% i tatimit mbi të ardhurat personale t'i kalojë pushtetit vendor dhe ka 3 vjet që nuk e kanë marrë, normalisht që opinioni publik, por edhe kryetarët e rinj të bashkive duhet ta dinë një përgjigje nga Ministria e Financave.

E dyta, nëse e kemi bërë 5% për ato bashki që përfitojnë nga renta minerare, pse nuk e marrin?

E treta, me ligjin për pushtetin lokal bashkive u kanë kaluar shumë funksione të deleguara, përpos funksioneve bazike që ka me ligj cdo bashki. Së fundi, u kaluam edhe një strukturë të dedikuar për diasporën dhe migracionin. A buxhetohen si duhet bashkitë e reja për funksionet e deleguara me ligj?

Urdhëroni!

Brahimaj - Faleminderit!

Së pari, dua të shtoj disa gjëra në lidhje me reformën territoriale. Pushteti vendor investon jo më pak se 1,5% të GDP-së vetëm nga fondet e veta, nga taksat dhe nga transfertat e pakushtëzuara, që do të thotë se nga investimet publike që bën gjithë vendi rreth 30% bëhen nga pushteti vendor.

Së dyti, po të shohim të ardhurat (sigurisht që bashkitë e mëdha kanë një diferencë shumë më të madhe), janë mesatarisht 2,5 herë më të larta se para reformës territoriale. Gati të gjitha bashkitë kanë një tendencë të rritjes së të ardhurave.

Së treti, për tatimin mbi të ardhurat personale dua të theksoj se paratë kanë mbetur pa u transferuar vetëm për një problem teknik. Ky problem ka qenë harmonizimi i dy sistemeve, sepse nuk i lidhim dot të dhënat në sistemin e gjendjes civile me të dhënat të tatim-taksave. Ky problem është zgjidhur duke përdorur një kriter transitor, numrin e popullsisë. Ne e kemi bërë gati që të këtë vit dhe do të shpërndahen edhe ato të vitit të kaluar, por për vitin 2020 do të jetë e sigurt se do të jenë në buxhetin e bashkive.

Së katërti, për rentën minerare është parashikuar në strategjinë e Ministrisë së Financave që nga 5% ajo të rritet në 8% vitin që vjen.

Kërkesa e pushtetit vendor ka qenë që niveli i shpërndarjes të jetë më i lartë dhe kjo është marrë parasysh në vitet e që do të vijnë.

Së pesti, te funksionet e deleguara është shtuar edhe një funksion i ri për diasporën. Kjo gjë është kaluar me debate dhe është një funksion që nuk do të shoqërohet me faturë financiare dhe shoqatat e bashkive e kanë pranuar këtë, duke përlogaritur që investimi dhe gjithë puna që bëhet me diasporën të jetë më shumë përfituese se sa mund të shpenzojnë bashkitë.

Si parim, edhe për ligjin e financave vendore, edhe për ligjin e organizimit të veçorisë vendore është se çdo funksion që ka dalë nga pushteti qendror në atë vendor duhet të shoqërohet me faturën e nevojshme financiare.

Së gjashti, jo më pak se 1% e GDP-së të jetë transfertë e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore, pra nuk bën diferencimin mes bashkive dhe qarqeve. Për këtë vit transfertat e pakushtëzuar ka qenë pak më shumë se 1%.

A ka nevojë që të jetë më shumë? Sigurisht që ka nevojë, se nevojat e bashkive janë shumë herë më të larta se sa ju kemi akorduar, por duke stabilizuar nivelin e të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar, nga transfertat specifike dhe nga burime të tjera ka bërë që një pjesë e mirë e bashkive, duke i ditur këto mundësi janë mobilizuar shumë për të rritur të ardhurat e veta, sepse shumica e bashkive, kryesisht këto të mëdhatë, rreth 70-80% të buxhetit të tyre e sigurojnë nga taksat dhe tarifat vendore.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, e kam me atë që zoti Fino paraqiti. Unë nuk dyshoj aspak te ana profesionale (se u bënë kaq vite që ndjek çështjet e buxhetit, aq më tepër që ai e njeh shumë mirë pushtetin lokal), por doja t'i thosha zotit Fino se anëtarët e komisionit nuk janë të gjithë të profilizuar vetëm për problemet e buxhetit dhe financës.

Doja të bëja një sugjerim që ka të bëjë me ato që përmendi kryetari i bashkisë së Tiranës. Jam me fat që jam deputet i Tiranës dhe mendoj se të gjithë kolegët e mi që janë këtu në këtë sallë, deputetë nga rrethe të ndryshme, vijnë këtu dhe shohin zhvillimet dhe transformimin e madh që ka pasur Tirana (sheshin “Skënderbe”, pazarin, parkun, bulevardin, stadiumin e ri), por Tirana nuk përfundon këtu se ajo është shumë e madhe dhe vazhdon edhe në periferi dhe të gjitha ato çka përmendi zoti Veliaj janë reale dhe ndryshimi ka nisur në këto zona, jo vetëm duke transformuar qendrat urbane, por edhe zonat periferike (çka ka bërë Kryeministri).

Para disa kohësh ne kemi miratuar ligjin “Për emergjencat civile” dhe aty është përcaktuar që rreth 4% e buxhetit të kushtëzuar duhet të kalojë për këto emergjence. Nuk e di cili është komenti i bashkive dhe a e keni planifikuar ju këtë, pasi dihet që Shqipëria është goditur nga fenomene të tilla, siç janë tërmetet, zjarret, përmbytjet?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Sako!

Valbona Sako – Faleminderit, kryetar!

Impakti që jep puna që bëjnë bashkitë ndihet direkt në komunitet dhe për shkak të problematikave që shfaqen atje konsiston edhe kërkesa për fonde ose zbatimi i ligjshmërisë për 1%-shin, 2%-shin apo edhe për rastin që adreson deputeti Qefalia.

Realisht, çdo bashki e ka detyrim ligjor që të ketë fondin e kontigjencës. Ky fond kontigjence është në varësi të mundësive financiare që ka një bashki. Ky është një atribut ose një detyrim ligjor edhe për qeverisjen qendrore.

Duke parë edhe zhvillimet e fundit, sigurisht që po e planifikojmë në buxhet, sepse jemi në fazën e planifikimit të buxhetit, por jemi të kufizuar gjithmonë në parashikimin e shumave, se asnjë nuk mund ta parashikojë se janë emergjence, por e kemi detyrim ligjor dhe sigurisht që do jenë në buxhet.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Veliaj!

Erjon Veliaj – Kam një përditësim për situatën e menaxhimit të tërmeteve. Dua t’ju bëj me dije, po marr si shembull bashkinë e Tiranës, por besoj se vlen për të gjitha bashkitë e Republikës, se nuk mbaj mend të ketë pasur një situatë emergjence që të jetë përballuar me kaq dinjitet dhe me kaq zhdërvjellësi burokratike në një vend ku burokracia është kampion.

Ne si bashki kemi filluar rindërtimin e shtëpive kryesore që kanë qenë të rrënuara totalisht, të shpallura të pabanueshme në fshat. Përpara festave të nëntorit një pjesë e mirë e tyre do të hynë në shtëpitë e reja, ndërkohë që para vitit të ri do të hyjë pjesa e tjetër, pra rreth 40-50 shtëpi që kanë qenë totalisht të rrënuara i kemi adresuar në këtë mënyrë. Ndërkohë, këtë

ditë në këshillin bashkiak do të kalojmë 500 dëmshpërblimet e para, para cash në dorë, në bazë të vlerësimeve, ende pa u mbushur dy muaj nga tërmeti, 21 shtator-21 nëntor.

Kjo nuk përbën ndonjë krenari të madhe, sepse ky është një detyrim. Dua të vë theksin se ne jemi një vend ku sigurimet nuk funksionojnë (nuk e siguron njeri shtëpinë), prandaj dua t'u them njerëzve se, kur e përplas makinën, a i thua shtetit të ta paguaj? Pra, normalisht kjo duhet të jetë logjika, se pronën e vet gjithkush duhet ta sigurojë siç siguron makinën.

Duke qenë se situata është e jashtëzakonshme, nuk është momenti për të treguar ligjin, por është momenti për të treguar solidaritet teksa shoqëria të fitojë një lloj pjekurie për të kuptuar që prona jote është vetëm jotja dhe bashkia nuk vjen as të zhbllokojë galixhantin e banjës, as të të ndërrojë poçin apo tarracën, se ajo është pronë jotja dhe është privatizuar që në vitin 1993.

Për të gjitha këto arsye, sistemet ecin paralelisht.

Pse them që jam krenar për performancën e bashkive? Unë kam qenë, mbaj mend edhe si kryetar bashkie, në Matricen dhe në Akuila. Në tërmetin e Akuila-s ndodhi në vitin 2009, pjesa më e madhe akoma sot në 2019-n nuk kanë marrë akoma dëmshpërblimet dhe akoma nuk është rindërtuar, kush ka shkuar dhe e ka vizituar pjesën e prekur nga tërmeti mund ta ma konfirmojnë. Po flas për një vend anëtar i G7-ës. Aty, jo se nuk kanë para, se që kur ishte Kryeministër Berluskoni (Akuila ka ngrenë nja 10 kryeministra në Itali), ka pasur vullnet, por vetëm për shkak të burokrative, verifikimit, pronave, titujve, sa metra, sa dëme, dikush hyri si mashtrues dhe tha shtëpia që nuk jetonte prej kohësh, janë gjëra që na ndodhin edhe ne. _Ka njerëz që jetojnë në mes të Londrës dhe thonë “Ra tërmeti, të kap ndonjë gjë te shtëpia”, ku në fakt pema ishte rritur brenda shtëpisë prej 10 vjetësh, se nuk banonte njëri. Pra, spekulues ka kudo nëpër botë, por është fakt që një vend modest e përballon me dinjitet, pa ndonjë panik dhe me të gjitha strukturat e shpëtimi-kërkimit, të emergjencave dhe të ndihmës së shpejtë, por ndodhi edhe brenda dy muajve, ju kujtoj se me qeverinë e kaluar akoma nuk janë zgjidhur dëmet nga përmytjet në Shkodrës të para disa viteve, që tregon se kemi vendosur një etalon të ri si bashki me qarqet, ku në kohë rekord po bëjmë edhe dëmshpërblimet, po solidarizohemi me ndërtuesit dhe me njerëz të tjerë, të cilët kanë thënë “Sa të bëhen letrat të bëjmë shtëpinë, pastaj flasim!”.

Kështu që dua ta vlerësoj rolin e bashkive.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Veliaj!

Disa kolegë kanë kërkuar fjalën për të bërë disa pyetje, por do t'u kërkoja që pyetjet të jenë në sensin se sa ne si komision dhe si deputetë mund t'i mbështesim bashkitë e reja dhe Shoqatën për Autonomi Vendore në adresimin e nevojave buxhetore në buxhetin e vitit 2020.

Sot ata janë këtu për të raportuar se çfarë kanë kërkuar, çfarë nevojash kanë, çfarë kanë marrë dhe si mund t'i mbështesim. Ky është vullneti që duhet të kemi!

Po, zoti Përmeti.

Andi Përmeti – Unë kam një pyetje dhe një konstatim për zonjën Sako.

Si fillim, doja t'ju komplimentoja, jo juve personalisht, por si pushtet bashkiak, duke qenë se jeni i vetmi pushtet bashkiak korrupsioni i të cilit ka tejkaluar kufijtë e vendit tonë, duke shkuar deri në SHBA. Jeni e vetmja bashki, kryetari i së cilës e ka të ndaluar hyrjen në SHBA.

Ulsi Manja – Çfarë lidhje ka kjo?

Andi Përmeti – A ta mbaroj mendimin, se ke 1 orë që bën politikë?

Ulsi Manja – Jemi këtu për buxhetin.

Andi Përmeti – Kaluam jashtë buxhetit me plane 2-vjeçare.

Ulsi Manja – Edhe me plane 10-vjeçare.

Andi Përmeti – A mund ta mbaroj fjalinë?

Ulsi Manja – Mund ta mbarosh, por jo me politikë!

Andi Përmeti – Kaq larg sa e keni çuar jeni për t'u komplimentuar si pushtet lokal. Doja t'ju bëja një pyetje specifike për buxhetin.

Duke qenë se jeni i vetmi pushtet lokal që keni shkatërruar çdo trashëgimi kulturore të Durrhut të vjetër, e cila, për fatin tonë të keq nuk është vetëm trashëgimia juaja, por e të gjithë shqiptarëve, edhe imja, që jam korçar dhe jetoj në Tiranë. A keni një plan të ndryshëm dhe një specifikim në buxhet për të ruajtur këtë trashëgimi kulturore, apo do të vazhdoni ta betonizoni çdo centimetër të Durrësit?

Faleminderit!

Ulsi Manja - Po, zonja Sako.

Valbona Sako – Besoj se e keni fjalën për ndërtimet e reja, që janë në funksion të ruajtjes së trashëgimisë kulturore!? Përpara se të miratohet dhe të shkojë te leja e ndërtimit, një ndërtim i tillë ai kalon në disa faza, dhe një nga këto është edhe trashëgimia kulturore, për të cilën merret leja për arkeologjinë. Pra ka disa struktura që finalizojnë këtë proces. Nuk mund të them se Durrësi është shkatërruar, sot jemi 30 vjet pas fillimit të demokracisë, nuk mund të themi se kush e ka bërë këtë shkatërrim, por besoj se të gjithë kemi pjesën tonë. Uroj që 4 vitet e mia në Bashkinë e Durrësit ta bëjnë atë më të jetueshëm si për qytetarët shqiptar, ashtu dhe turistët.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Kush ka pyetje?

Po, zonja Bode,

Edlira Bode – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Veliaj, unë nuk jam anëtare e përhershme e këtij komisioni, jam zëvendësuese dhe më vjen mirë që u ndodha sot, sepse kam mundësinë t'u bashkohem komplimenteve që ju bëri zoti Qefalia për atë që ju bëni çdo ditë dhe për atë që keni bërë që nga fillimi i marrjes së detyrës për Tiranën, por ju falënderoj në mënyrë të veçantë për avokatinë dhe mbështetjen që u bëni bashkive të vogla. Unë përfaqësoj Bashkinë e Devollit në qarkun e Korçës, e cila është një bashki e vogël dhe me probleme të shumta.

Faleminderit që vini vëmendjen në mënyrë të veçantë te problematikat që duhet të përballojnë këto bashki me buxhete jo të konsiderueshme.

Thënë këto kisha një pyetje në lidhje me strehimin social. Para një viti ne kemi miratuar një ligj, i cili menduam se do t'i jepte një zhvillim të mirë zgjidhjes së problemit të strehimit social në të gjitha bashkitë e vendit, sepse përfshimë aty shumë kategori dhe një lloj detyrimi që i jepte ndërtuesve që përtej një sipërfaqeje të caktuar të vinin një dispozicion të strehimit social.

Në përvojën tuaj si ka ndikuar zbatimi i këtij ligji në zgjidhjen e problemit? A ka, apo jo një ndryshim në bashkinë tuaj, që është më e madhja, dhe a mendoni se e njëjta gjë funksionon edhe për bashkitë e vogla?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Veliaj.

Erion Veliaj – Më vjen keq ta konstatoj që ligji nuk është zbatuar, sepse nuk ka akte nënligjore, të cilat duhet të sqarojnë. Njësoj është 3 përqindëshi në Bllok me 3 përqindëshin në Kashar? Nëse një familje e komunitetit Rom merr një apartament në Bllok, ku taksën e pronës (tani me taksën e re të pronës) e ka shumë më të lartë, sepse vlera e shtëpisë është më e lartë, a është njësoj? I kthehet në shpëtim, apo në bela mbajtja e asaj shtëpie me një taksë aq të lartë, që në fakt, do të ishte më e lartë se çfarë do të paguante në një banesë sociale të Bashkisë së Tiranës? Kështu që më mirë të rrijë në një banesë sociale të Bashkisë së Tiranës me 15 mijë lekë sesa të paguajë 20-25 mijë lekë taksë. Për të gjitha këto arsye lipson akte nënligjore, që nuk kanë dalë. Ne u munduam në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak që të nxirrnim vetë një procedurë, sipas së cilës, përpara se të marrë kolaudimin, një ndërtues mund të zgjedhë, se për arsye të tilla ai mund të thotë “Më mirë t'i paguaj në *cash*” dhe futet në një fond strehimi, pra ta paguajë 3 përqindëshin e vlerës me para *cash*, pastaj fondin e strehimit bashkia e përdor për strehimin social. Pra ose ndërton vetë, ose merr me qera, ose zhvillon pronën e gjëra të kësaj natyre. Ne mezi po i japim zgjidhje në Tiranë, ndërsa për bashkitë e vogla përgjigjja është

zero, pra nuk ka asnjë akt nënligjor ku ta bazojmë zbatimin. Një ide shumë e mirë rrezikon të mos zbatohet, sepse nuk ka një instrument.

Arsyeja tjetër: fjala vjen, një ndërtues ndërton në një vend me një kompani dhe ligji i ka dhënë mundësinë ta kompensojë në një vend tjetër, por ai në atë vendin tjetër ndërton me një kompani tjetër, pra nuk ekziston as mënyra juridike si ta detyrosh. Ai mund të thotë që nuk do të ndërtojë më pas kësaj dhe nuk ke ku ta kapësh që ta penalizosh herës tjetër. Ai thjesht mbyll numrin NIPT dhe hap një llogari tjetër dhe nuk është më i njëjti ent juridik.

Pra, na lipsen këto akte nënligjore që kjo të bëhet e zbatueshme.

Ky parlament ka marrë një vendim shumë të mirë, për të fuqizuar pilotin që ne bëmë në Tiranë, për kreditë e buta edhe në bashkitë e tjera. Qeveria ka kaluar një propozim dhe është miratuar nga parlamenti për banesat sociale. Unë besoj shumë që kreditë e buta janë një instrument shumë më i mirë. Gjithmonë shoh në aktivitetet që bëjmë në Tiranë që diçka që është falas, pavarësisht se është cilësi shumë e lartë, që e ka sponsorizuar një ambasadë, njerëzit janë duke bërë muhabet, shohin celularin, se e shohin si diçka të pavlerë, po ta bësh me lek, që në fillim thonë *sold out*, u shitën menjëherë, sepse mendojnë se, meqë është me lekë, ka vlerë. Pra kur u thua “Merre këtë shtëpi, se e ke falas nga emergjencat”, ajo kthehet në një kazan plehrash dhe kostoja jonë e amortizimit dhe e riparimit të atyre mjediseve është e jashtëzakonshme. Merr një kredi të butë, ku bashkia paguan interesin, dhe tani që qeveria ka kaluar një fond për t’i paguar këto interesa dhe bashkitë e tjera, praktikisht e ke fuqizuar një familje të re, e cila thotë “Në vend që të marr me qira, çdo muaj me atë qira blej një metër katror, se falë kredisë së butë më është amortizuar e gjitha”. Nuk paguan as inflacionin e lekut, pra praktikisht bëhet fjalë për para falas. Për të gjitha këto arsye unë them më mirë projekte që nuk shtojnë këtë përtacinë dhe shtetin në dado, (jemi të majtë, por jo dado). Shteti para 30 vjetësh ishte dado, se çdo gjë e caktonte shteti, me kë do të martohesh, ku do të shkoje të bëje zborin, ku do të punoje, e me radhë. Tani duhet të ndërtojmë një shtet i cili është social, të ndihmon të përshkosh, por nuk të jep peshk falas. Unë them më mirë t’i ndihmojmë njerëzit të peshkojnë, sepse na rezultojnë mbi 1000 apartamente që janë shpërndarë në Tiranë, një pjesë të cilave kam pasur kënaqësinë t’i vizitoj vet dhe vë re që kanë një ndjenjë krenarie se është e tyrja, se nuk kanë kërkuar lëmoshë, por i kemi ndihmuar duke u amortizuar kredinë dhe besoj se është një nga projektet më të suksesshme. Për mendimin tim, më shumë se të bëjmë akrobacira me 3 përqindëshin e përealizueshëm, të gjejmë një mënyrë si të shtojmë fonde për të zënë, jo për të falur peshk.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Lita ka një pyetje të fundit si nënkryetar i komisionit.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, zoti Veliaj!

Përshëndetje të ftuarve!

E kam më shumë në formë diskutimi në lidhje me rentën minerare. Qytetet dhe rrethet që kanë burime natyrore në një këndvështrim krejt ndryshe nga vendet europiane ose të rajonit janë më të varfra, ndërkohë që në shtete të tjera janë qytete më të pasura, sepse Zoti u ka falur burime natyrore dhe i shfrytëzojnë.

Me sa di unë, aktualisht renta minerare është në vlerën 7% dhe 5% të saj e merr bashkia, por as këtë nuk po e marrin. Meqë këto bashki kanë ngelur të pazhvilluara dhe normalisht për arsye të ndryshme nuk marrin shumë investime publike, a mos ka ardhur koha që Shoqata e Bashkive të llojë që renta minerare të paguhet direkt në bashki dhe të përmbysset raporti, duke qenë se është pasuri e asaj zone dhe 5% ta marrë shteti nga bashkia?

Ulsi Manja – Po, zonja Sako.

Ju lutem, një përgjigje shkurt!

Valbona Sako – Është më shumë një pyetje teknike, sepse zoti Fino e sqaroi shumë mirë këtë pjesë. Jemi në të njëjtat kushte se 2 përqindëshi i tatimit mbi të ardhurat personale, që mbledhet nga qeveria qendrore, u alokohet bashkive. Mundësi teknike për t'u mbledhur nga bashkitë nuk ka, sepse renta mbledhet me deklaratë dhe i takon qeverisjes qendrore. Sot nuk po na kalojnë fonde për arsye teknike, kështu që edhe arsyet teknike duhet t'i marrim parasysht.

Korab Lita – Kjo është diçka që e njoh, se kam 15 vjet që merrem me të. Nuk është e vërtetë që mbledhet me deklaratë, zonja Farrici e di se vjen nga një qytet që ka burime natyrore, ashtu siç mund të ketë Tirana, apo Durrësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Valbona Sako – Nuk ka mundësi reale për ta mbledhur, se është pasuri kombëtare, nuk mund ta mbledhin bashkitë.

Korab Lita – Zoti Fino, unë e njoh ligjin dhe e di si paguhet, se jo më larg se para 3 ditësh kam paguar, por nëse ekziston dëshira për t'ua dhënë këtyre bashkive...

Bashkim Fino - ...të kontrollojmë qeverinë, Ministrinë e Financave dhe të themi “Pse nuk e zbaton ligjin që t'a kalosh 5% të rentës minerare organeve të pushtetit vendor?”. Na takon neve ta bëjmë këtë gjë, nuk ka rëndësi ana teknike si mbledhet, atë e mbledh shteti.

Korab Lita – Rrethet, që i kanë ato burime natyrore duhet të marrin pjesën e tyre, të luanit, por ata as atë nuk marrin. Të ndryshohet ligji! Që nuk i mbledh dot bashkia, këtë nuk e pranoj.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lita!

Bashkim Fino – Ndarja e taksave bëhet në mënyrë të barabartë nga shteti. Çdo gjë në Shqipëri, nën tokën e Bashkisë së Erion Veliaj, apo mbi të, është pasuri kombëtare, aeroporti është pasuri kombëtare, aktivitetin e bën në Tiranë, taksat portuale janë të jashtëzakonshme, por nuk i merr Bashkia e Tiranës, se po t’i merrte nuk do të kishte më nevojë për gjë dhe do ta bënte Tiranën lule, ose porti në Durrës, pra këto janë nocione ekonomike.

Korab Lita – Po t’i hyjmë këtij debati ka shumë për të thënë. Koncepti im është që pjesa kryesore t’u jepet bashkive edhe pse zgjidhja ligjore mund të mos jetë kjo imja.

Erion Veliaj – Lajmi i mirë sot për rentën është ajo që dëgjuam nga ministria. Kemi filluar një platformë, zonja Farrici është drejtoreshë e shoqatës, me OSBE-në që të shohim rritjen graduale çdo vit. Nga 5 do të shkojë në 8.

Korab Lita – Më 1 janar do ta kesh 8.

Erion Veliaj - Nëse ne vazhdojmë me këtë rritje dhe jepet në kohë, se edhe kjo është po aq e rëndësishme sa rritja, unë them që prapë është një progres.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Veliaj!

Meqenëse kemi mediet të pranishme, para se t’ia kaloi fjalën zotit Braho, pa ia zbehur aspak rëndësinë kësaj seance dëgjimore shumë të rëndësishme, ku janë të pranishme Shoqata e Autonomisë Vendore e kryesuar nga zoti Veliaj, zonja Sako dhe drejtoresha ekzekutive, zonja Farrici, por dhe për opinionin publik, ju njoftoj se ka pasur një reagim nga Shoqata e Bashkive, nuk e di a është më si shoqatë, sepse në detyrë është një individ jo i zgjedhur, se nuk ka marrë ftesë nga Komisioni i Ligjeve për të marrë pjesë sot. Këtë e them që të jemi transparent.

Ju lutem, zoti Fino!

Në datën 13 nëntor i ka shkuar njoftimi edhe pse është individ, jo kryetar bashkie, dhe nuk përfaqëson asgjë, sepse 60 bashkitë janë pjesë e Shoqatës së Autonomisë Vendore, që kryeson zoti Veliaj, pra i ka shkuar njoftimi në të njëjtën ditë. Në datën 15 nëntor nga zoti Agron Haxhimihali, që, si duket, është anëtar i vetëm që i ka ngelur asaj shoqate, komisioni është falënderuar për ftesën. Sigurisht është kërkuar relacioni i projektbuxhetit dhe sekretaria e komisionit, në zbatim të detyrës, ia ka vënë në dispozicion relacionin edhe projektbuxhetin e vitit 2020. Dje në datën 19 nëntor kemi pasur komunikimin e fundit ku thuhet: “Nuk mund të paraqitemi, por kemi sjellë relacionin me shkrim për projektbuxhetin e vitit 2020” arsyet i dinë ata, dhe e falënderon komisionin.

Si duket, tani ka marrë ndonjë porosi tjetër, por sot kryetari i Bashkisë së Tiranës, njëkohësisht dhe kryetar i Shoqatës së Autonomisë Vendore, është në Komisionin e Ligjeve si avokati i vetëm i 60 bashkive, që drejtohen nga PS-ja.

Projektbuxheti i vitit 2020, siç u parashtrua nga zoti Veliaj, por edhe nga zoti Fino dhe nga Ministria e Financave është në rritje, merr në konsideratë zhvillimin e bashkive tona dhe garanton progres dhe qëndrueshmëri. Unë e thashë edhe në fillim të fjalës sime, ai është pushteti më afër qytetarit. Zonja Sako tha që janë kaq afër me Tiranën dhe është ky ndryshim kaq i madh.

Zoti Braho kishte një pyetje për projektbuxhetin, por nuk e di a do të shtojë ndonjë gjë të relacioni i zotit Fino.

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Ato që do të them unë, zoti Fino do t'i parashikojë. Do të merremi vesh.

Shkurtimisht do të thosha që i falënderoj të dy kryebashkiakët, veçanërisht për entuziazmin që tregojnë këtu, por entuziazmi nuk është gjithçka. Më mbeti në mendje një pyetje që bëri zoti Qefalia, por më duket se nuk mori përgjigje. Fjala është për 4 përqindëshin e Fondit të Emergjencave. Konsiderojeni 4%-in si atë 2%-in që paguajmë për NATO-n, mos e lini variabël! As Veliaj nuk e tha e as ju nëse e keni parashikuar 4%-in. Thoni po ose jo dhe ta mbyllim këtë hesap!

Së dyti, kjo është për Finon. Fino, ti me të drejtë je angazhuar fuqishëm, edhe unë kur filloi reforma administrative e theksove që kjo reformë nuk është shoqëruar me reformën në sistemin e pagave. Nëse e mban mend kemi thirrur edhe ish-ministrin e Financave në interpelancë dhe me të gjithë problematikën që shfaqte atje nuk e çau kokën dhe më erdhi shumë keq për pozitën e vështirë në të cilën u vumë si Kuvend dhe ti si relator i asaj problematike.

Nëse nuk e bën qeveria reformën në sistemin e pagave, të jetë pjesë e relacionit, pjesë e detyrimit për të detyruar qeverinë të angazhohet në reformën e pagave. Le të paraprijë në këtë reformë pushteti lokal! Këtu i kemi të dy, por edhe këta katrahurë e kanë sistemin e pagave, prandaj duke sugjeruar dhe duke kërkuar prej tyre që ta shohin reformën në sistemin e pagave, nuk bëhet fjalë as për ngritje as për ulje, ato mundësi i shihni vetë, por situata nuk është e mirë.

Faleminderit!

Usi Manja – Faleminderit!

Zonja Hoti, a keni pyetje?

Ju lutem, shumë shkurt!

Zonja Hoti është e fundit dhe e mbyllim.

Elda Hoti – Faleminderit, zoti kryetar!

Gjej rastin të paraqes një problem emergjent për Bashkinë e Kurbinit. Prej vitesh, sa herë kemi reshje qyteti i Laçit përmbytet dhe nuk po merret asnjë masë konkrete emergjente

për t'i dhënë një zgjidhje. Përmytjet kanë shkaktuar dëme të mëdha për shumë familje dhe biznese. Kemi pasur humbje edhe jetësh njerëzore. Bashkia prej vitesh nuk po jep asnjë zgjidhje.

Zoti Veliaj, dua një mendim nga ju: kjo vjen për shkak të neglizhencës? Kryetarët e bashkive nuk kanë vullnet të kontribuojnë në zhvillimin e zonës apo realisht nuk kanë fonde, siç janë shprehur prej vitesh?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hoti!

Zoti Veliaj, si kryetar i Shoqatës së Autonomisë Vendore, në mos gaboj, pyetja ishte: si do të trajtohet Bashkia e Kurbinit?

Erion Veliaj – Për pyetjen e mikut tonë, zotit Braho, përgjigjja është po, bashkitë e kanë të detyrueshme, sepse nëse nuk respektohet kjo, buxheti nuk kalon në Këshillin Bashkiak, pasi është kërkesë ligjore. Sigurisht, 4%-shi është relativ. Tirana dhe Durrësi e kanë luksin të vendosin 1 milion euro emergjencë për pagesa qirash dhe për shtëpi provizore të atyre që dëmtohen. 4%-shi i Kurbinit është diçka ultramodeste. Besoj se duhet të diskriminojmë pozitivisht në favor të bashkive të vogla, ku mund të shtojmë nga pak. Ne kemi një hapësirë në Tiranë, ku bashkë me *cooperazione italiano* po instalojmë ose jemi gati të formojmë ndërtimin e një qendre kombëtare të emergjencave, që lidhet me Qendrën Ndërkombëtare të Emergjencave në Sllovaki për Europën. Duam të kemi një sistem raportimi, përgjigjeje në terren dhe mbledhje informacionesh, që quhet *situations room*, dhoma e situatave të emergjencave, shumë më të sofistikuar se ajo që kemi sot.

Ne në Tiranë kemi avancuar, por duke e pasur Tiranën dhe kombëtaren në një vend, kemi mundësi të japim një dorë, ndaj po kaloj te rasti i Kurbinit, ku patëm mundësi të jepnim ndihmë në Floq dhe në Korçë në rastin e tërmetit. Duke qenë bashki më të mëdha, me qendra dhe rezerva të qytetit me shtretër, me elektroshtëpiake, me batanije, me veshmbathje, me ushqime, i kemi kthyer në një etalon shumë të mirë, që mund të imitohen edhe nga bashkitë e tjera. Duhet të kenë vetëm një hapësirë, një magazinë dhe si milingonat, në ditë të mira, të vënë hambar dhe ta shpërndajnë kur të vijë dita e fatkeqësisë.

Mbaj mend vitin tim të parë si kryetar bashkie, ku pati shumë reshje, dhe më thoshin të gjithë: “Kryetar, mos e vrit mendjen, mos u shqetëso, sepse 1 herë në 100 vjet ndodh kjo gjë”.

Në vitin e dytë si kryetar bashkie ra borë në Tiranë. Hera e fundit që kishte rënë borë në Tiranë ishte viti 1985, kur unë isha 5 vjeç, dhe të gjithë trollësat në internet thoshin: “Ku i keni borëpastrueset”?

Si mund të kishim borëpastruese ne, kur kishte 30 vjet pa rënë borë? Këta thoshin: “Mos e vrit mendjen, kryetar, sepse 1 herë në 100 vjet ndodh që bie borë në Tiranë”.

Më pas pati thatësirë të madhe, që e përjetuam edhe në zonën e Astirit, ku është ndërtuar në mënyrë informale, me ujë pusi të *Coca-Cola*-s në Laknas, e cila mund t’i japë ujë vetëm një fabrike, ndërkohë që janë rreth 80 pallate, që nuk kishin lidhje me rrjetin. Më 28 gusht ...

Të gjithë ata që e kanë të lehtë të shajnë kryetarët e bashkive dhe nuk e kanë idenë që bëhet fjalë për zona komplet “mos o Zot”, tani që janë futur në Tiranë, thonë: “E duam si Tirana”. Patjetër. Do të marrim lekë nga qendra e Tiranës, që ka paguar gjithmonë taksa, për t’i hequr nga Laknasi, duke u tharë puset, si thatësira që nuk pati ujë për 182 ditë, ku më thanë: “Kryetar, mos e vrit mendjen, sepse kjo ndodh 1 herë në 100 vjet”.

Më pas ra tërmeti dhe më thanë sërish: “Kryetar, tani që e menaxhuam këtë, mos e vrit mendjen, sepse edhe kjo ndodh 1 herë në 100 vjet”.

Çfarë dua të ilustroj me këtë, përtej humorit? Po jetojmë në një situatë klimatike, ku ato që më parë ndodhnin 1 herë në 100 vjet, tani po ndodhin çdo vit.

Kryetarja e Bashkisë së Kurbinit në rrethin e Laçit nuk është këtu dhe nuk na e di nëse po na dëgjon. Nuk po bëj avokatin e saj, por dua që ky të jetë jo vetëm një proces kritike, por edhe një proces emancipimi.

Do të jap shembullin e Venecies. Pas ironisë së fatit që ndodhi në Venecie, ku uji kaloi 1,70 metër thellësi, më shumë se gjatësia mesatare në këtë sallë, në një shtet të G7 dhe në Veneto, një nga rajonet më të pasura të Italisë, u mbledh Këshilli Bashkiak. Kryetari i bashkisë propozoi si mund të investohej më shumë për ndryshimet klimatike. Këshilli bashkiak, për inat politik, ia hodhi poshtë. Teksa hodhën poshtë propozimin, duke qenë të pranishëm, salla u mbush me ujë, dhe vendimet u fluskuan. Nuk e di nëse i patë fotot e famshme nga Këshilli Bashkiak i Venecies.

Situata është e tillë. Një kryetar bashkie, edhe të jetë supermen, nuk ka çfarë të bëjë me ndërtimet që janë bërë në një pafundësi territoresh, në hapësira publike ku më parë kullonte uji, dhe i njëjti ujë kullon sot në më pak hapësirë, sepse kanë ndërtuar, kanë vënë gardhe. Ndaj u themi të ulin gardhet.

Unë kam qenë në Laç, kam miq dhe staf nga Laçi dhe shtëpitë në periferi të Tiranës apo në periferi të Kurbinit rrethohen sikur të jenë ambasadë amerikane. Të gjitha këto janë barriera. Është si kulluese makaronash. Sa më shumë vrima të kullueses të zihen, aq më shumë ujë nuk kullon. Disa gjëra janë të trashëguara ndër vite, nuk ka çfarë të bëjë kryetarja e bashkisë. Ajo mund të prishë vetëm gjysmën e Laçit. E duam këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka disa raste konkrete në Tiranë. Do t'i them, sepse jam i sigurt që ilustrojnë situata të ngjashme.

Kur unë kam qenë fëmijë, në zonën e Kombinatit, pas “Kombinatit Tekstil” ka qenë fushë bujqësore, ka qenë e gjitha fermë, kooperativat e qëmotit. Përroi i Shaban bardhoshit është realisht një Venecie shqiptare, sepse të gjithë kanë ndërtuar në kanal. Unë shkoj shpesh aty. Ju e dini që edhe kur bëjmë punë vullnetare, dal vetë, sepse po nuk dola unë, thonë njerëzit: kur ky nuk del vetë, pse të dalim ne? Atje kemi nxjerrë kolltukë, frigoriferë, lavatriçe, që i hedhin vetë banorët. Ne do të kërkojmë llogari nga qeveria dhe nga bashkia, por, mbi të gjitha, duhet të fillojë një proces i madh emancipimi. Këto përrenj që the, nuk zihen nga një pushtues; nuk vjen shkau dhe të zërë përroin e Laçit dhe të Shaban Bardhoshit. Një nga ata hedh frigoriferin dhe divanin, sepse përton t'i çojë te plehrat.

Tjetra, kur do të mbarojë? Ne nuk jemi shtet i pasur. Kur Venecia dhe Aquila nuk po marrin lekët, kur Venecia përmytet; teksa Këshilli Bashkiak merr vendime hyn më shumë se 1,70 metër ujë brenda, për vende si ne duhet një emancipim i jashtëzakonshëm. Ne kemi filluar të bëjmë seanca me fëmijët, me zjarrfikëset, si të bëjmë evakuim me familjet. Ne kemi filluar tani, për shkak të emergjencave, në çdo institucion publik. Unë jam gjithmonë i parimit “rëndësi ka jeta, sepse të tjerat i rregullojmë”.

Përmytjet ndodhin edhe në Tiranë. Në momentin që bie për 2 orë ajo që më parë binte për 3 muaj, kapaciteti për të thithur është më i vogël. Nga Lana ne nxjerrim çudira që juve nuk jua pret mendja, të cilat i botojmë shpesh. Kjo është çështje kulture, jo infrastrukture.

Unë besoj se duhet t'u themi qytetarëve: keni të drejtë, por a keni përgjegjësi? Vetëm të drejta keni në këtë vend? Kur ndërtove në përrua, duke e ngushtuar, pse nuk u mendove? Përroi apo lumi ka disa shtresa, ka shtratin e vetë 50-vjeçar, 1 herë në 50 vjet ka një shtrat të dytë, 1 herë në 100 vjet ka një shtrat të tretë. Shtrati i tretë dhe i dytë janë ndërtuar. Unë i kam parë vetë te bregu i lumit. U them njerëzve: dakord, shërbimi do t'ju vijë edhe aty, por kam një pyetje: a i shkove ti lumit dhe përroit, apo erdhi përroi tek ty? Për të gjitha këto arsye, nëse doni që kryetarët e bashkive të jenë më eficientë, duhen mbështetur publikisht. Pra, nëse janë disa mure që duhen prishur dhe uji të kullojë, të përmyten bahçet, por të paktën të kalojë uji. Në momentin që ti e ke vënë në mors, sigurisht që edhe uji do të marrë kohën e vetë.

Nga ana tjetër, borë dhe tërmete në Shqipëri kanë ndodhur edhe më parë, thjesht nuk kemi pasur *facebook*. Tani na ka kapur histeria: ra shi, shikoni çfarë po bëhet në filan rrugë.

Patjetër, je brenda në makinë, je duke xhiruar, u lagën gomat e makinës. Pra, a është realisht kjo situatë për të bërë panik? Ne shqyr që nuk kemi halle të mëdha, sulme terroriste dhe çudira.

Unë mbaj mend historinë e *New York*-ut, kur ranë kullat. Ka të bëjë shumë një popullatë e trajnuar, e cila të thotë se në këtë botë mund të ndodhë çdo gjë, mund të ndodhë tërmet, mund të ndodhë një sulm terrorist, mund të ndodhë një përmytje, mund të ndodhë një thatësirë, por paniku nuk është zgjedhje, historia nuk është zgjedhje, memet nuk janë zgjedhje. Lipset emancipim, bashkëpunim dhe më pas disa vendime të vështira.

Në Tiranë, kryetarët të rinj duhet të përballen që në fillim me vendime të vështira. Unë jam i parimit që nëse janë disa gjëra të vështira, më mirë bëji. Nëse duhet bërë lumi i Tiranës, do të prishen, do të sistemohen diku tjetër, por nuk vazhdojnë më aty, sepse do të jetë gangrenë. Kanë shpëtuar njësia 4, njësia 8, njësia 9 dhe njësia 11. Mbaj mend te liqeni. Unë e di çfarë kam hequr nga deputetë këtu, që thoshin “Pse shkel të drejtat e strehimit për romët”. Jo, romët janë më mirë ku i kemi çuar në Shkozë, sepse kanë shtëpi, por kanë fituar edhe liqenin e Tiranës. A ishte vendim i lehtë? Jo, ishte vendim shumë i vështirë, por nëse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di, por për kryetarët që keni duhet të thoni përtej politikës, që nëse janë disa gjëra për t’u prishur, që të kullojë uji, nëse janë disa investime për t’u bërë, t’i sistemojmë njerëzit diku tjetër, por duhet të marrim vendime të vështira, jo për politikën e ditës, por për gjeneratën që po vjen, që nuk ka borxh të trashëgojë gabimet e bëra në vitet ’90.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Veliaj!

Pas kësaj dëgjese publike për buxhetin e vitit 2020 prej afro 2 orësh, që mendoj se ia vlejti, sepse janë 61 bashki që ju përfaqësoni dhe problematikat që kanë janë të ndryshme, dua të bashkohem me konstatimet dhe sugjerimet e kolegut Fino, sepse do të bëjmë gati raportin për Komisionin e Ekonomisë, që është komisioni përgjegjës, por, njëkohësisht, nesër do të kemi edhe votimin nën për nën të buxhetit në Komisionin e Ligjeve.

Si përfundim, unë bashkohem me relatorin, që në raport të gjejnë vend tatimi i të ardhurave personale, t’i shpërndahet 2%-shi menjëherë pushtetit vendor, të vihet theksi te 5%-shi i rentës minerare për ato bashki, në territorin e të cilave gjenden këto pasuri natyrore. 1%-shi që e jep ligji, që është dysHEME e produktit të përgjithshëm, duhet të harmonizohet duke hequr pjesën e qarqeve, të cilat nuk kanë pse të llogariten në 1%-shin e buxhetit të bashkive.

Dua të mbështesim nismat ligjore që propozon kryetari i Bashkisë së Tiranës, nismën për përcaktimin e kufijve apo një ligj të posaçëm për kryeqytetin. Unë kam qenë partizan para 3 vjetësh, sepse në Komisionin e Ligjeve kemi pasur një vizitë nga Komisioni i Ligjeve i

Kosovës dhe i pushtetit vendor në fazën kur po draftohej ligji “Për Prishtinën kryeqytet”. Pse të mos e kemi edhe ne?!

Më duket interesant sugjerimi i kolegut Fino dhe nuk e di nëse duhet ta bëjmë pjesë të raportit për Komisionin e Ekonomisë amnistinë për borxhet e vjetra të bashkive, që i trashëgojnë, sepse do të ishte një frymëmarrje e madhe ekonomike për bashkitë e reja, sidomos për bashkitë e vogla. Bashkohem me zotin Veliaj, një gjë e tillë bën sens, duke pasur parasysh që nuk është një vlerë e madhe dhe do të ishte një zgjedhje për bashkitë e vogla, që vazhdojnë të paguajnë borxhet e ish-komunave.

Gjithsesi, biem dakord me këto sugjerime për t’u bërë pjesë e raportit.

E falënderoj zotin Veliaj, kryetar i Shoqatës për Autonomi Vendore dhe njëkohësisht kryetar i bashkisë së kryeqytetit, zonjën Sako si nënkryetare e Shoqatës për Autonomi Vendore dhe kryetare e bashkisë së Durrësit, si dhe zonjën Farici si drejtoreshë e Shoqatës për Autonominë Vendore!

Fakti që ishit prezent sot në Komisionin e Ligjeve tregon impenjimin, seriozitetin dhe përkushtimin që Shoqata për Autonominë Vendore, si përfaqësuese e 60 bashkive në të gjithë Shqipërinë, tregon jo vetëm mbarëvajtjen e punës në këto bashki, por edhe kujdesin e duhur që kryetarët e bashkive kanë për qytetarët. Ju keni marrë një mandat të drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe jeni hallka e parë e zgjedhjes së problemeve që kanë qytetarët në përditshmërinë e tyre, ndërsa ne si pushtet legjislativ, si deputetë të Komisionit të Ligjeve, por në veçanti si Nënkomisioni për Pushtetin Vendor, që është në përbërje të komisionit dhe drejtohet nga kolegu Fino, kemi detyrë t’ju mbështesim siç duhet, të jemi zëri i fuqishëm i mbrojtjes së interesave të qytetarëve, të bashkive në qeveri dhe në Kuvendin e Shqipërisë.

Mua më vjen mirë që zoti Fino këto 2 vjetët e fundit e ka bërë shumë aktiv Nënkomisionin për Pushtetin Vendor. Gjej rastin të ftoj një pjesë të kolegëve jo vetëm të Komisionit të Ligjeve, por edhe deputetë të komisioneve të tjera, që, kur zoti Fino të mbledhë Nënkomisionin për Pushtetin Vendor, të jeni të bindur se e mbledh për të trajtuar probleme jetike për qytetarët. Ne këtë vit është mbledhur jo pak.

Faleminderit kolegëve!

Faleminderit përfaqësuesve të Shoqatës për Autonomi Vendore, të pranishmëve në sallë dhe një falënderim të veçantë kam për medien, sepse jam i bindur që mediet sot i kanë lidhur siç duhet zërin dhe shqetësimet e qytetarëve me zërin dhe avokatinë e atyre që kanë zgjedhur për t’u kujdesur për ta!

Ditë të mbarë dhe faleminderit!

Mbyllet mbledhja e komisionit për ditën e sotme, për të vazhduar me dëgjuesën e radhës.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA